

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7157
E enjte, 4 prill 2024
Çmimi 0.50

Ish-diplomati amerikan: Nuk kam dëgjuar asnjëherë që Veseli të ketë qenë i përfshirë në ndonjë arrestim

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NGA 3 PRILLI ME RREGULLA DHE DËNIME TË REJA TRAFIKU NË KOSOVË

FAQE 5



Nga 3 prilli në Kosovë ka nisur së zbatuari Ligji i ri për rregullat e trafikut rrugor, i cili ka për qëllim

veçanërisht rritjen e sigurisë rrugore dhe mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së

pjesëmarrësve në trafik, dhe parashihet masa më të ashpra ndëshkuese për kundërvajtësit

KURTI VIZITON KOMUNAT NË VERI

F. 8



VIZITË NORMALE NË MOMENT JONORMAL DHE ME PRAPAVIJË JONORMALE

F. 7

Shkruan: Milazim
KRASNIQI



AKTUALE



UKRAINA NIS REGJISTRIMIN E DËMEVE TË LUFTËS

F. 2


OSMANI PRET NË TAKIM BOUYXIN, DISKUTOJNË PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS

F. 3

GNK: KOSOVA TË BASHKËPUNOJË ME KFOR-IN PËR ÇMILITARIZIM TË VERIUT DHE TË MARRË HAPA PËR VETËQEVERISJE TË SERBËVE

F. 5

EKONOMI



ATK-ja: 25.8 MILIONË EURO MË SHUMË TË HYRA TATIMORE SESA NË TRE MUAJT E PARË TË VITIT TË KALUAR

F. 7

PAGAT E ULËTA, OSHP-ja PËRBALLET ME MUNGESË TË STAFIT

F. 7

SPORT



KUPA E KOSOVËS: BALLKANI MPOSHT SUHAREKËN, PRISHTINA DHE DRITA LUAJNË PA GOLA

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina nis regjistrimin e dëmeve të luftës

KIEV, 3 PRILL - Kievi ka hapur online Regjistrin e Dëmeve dhe u ka bërë thirrje ukrainasve "të kërkojnë kompensim për dëmet apo shkatërrimin e pronave të banimit" që janë shkaktuar gjatë pushtimit rus të Ukrainës, që nisi në shkurt të vitit 2022, bëri me dije ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba.

Përmes një postimi në "X", Kuleba shkroi se gjatë adresimit në Konferencën në Hagë më 2 prill, ai theksoi se "ukrainasit kanë nevojë për drejtësi tani. Jo në një të ardhme të largët".

Në deklaratën përfundimtare të konferencës për drejtësi për Ukrainën, përfaqësuesit e 44 shteteve dënuan "aktet e agresionit nga Federata Ruse

kundër Ukrainës" dhe konfirmuan zotimin e tyre për krijimin e një "tribunali të posaçëm për hetimin dhe ndjekjen e krimit të agresionit kundër Ukrainës".

Në deklaratë u tha se Rusia duhet të përballet me të gjitha "pasojat ligjore për të gjitha aktet e saj të paligjshme ndërkombëtare... përfshirë reparacionin për lëndimet apo çdo dëm të shkaktuar nga këto akte".

Përmes një postimi në rrjetet sociale, ministri i Jashtëm i Holandës, Hanke Bruins Slot, që ishte nikoqir i konferencës, lavdëroi regjistrin e krijuar nga Kievi, duke thënë se ishte një përparim "për të arritur deri te llogaridhënia dhe kompensimi". Më 3 prill, Kuleba merr pjesë në

takimin e kryediplotëve të NATO-s në Bruksel. Takimi mbahet një ditë pasi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, propozoi krijimin e një fondi pesëvjeçar në vlerë prej 100 miliardë dollarësh për t'i ofruar armë Ukrainës.

Një burim nga NATO u tha gazetarëve se "ministret e Jashtëm do të diskutojnë për mënyrën më të mirë të organizimit të mbështetjes së NATO-s për Ukrainën, për ta bërë mbështetjen më të fuqishme, më të parashikueshme dhe afatgjatë". Megjithatë, për këtë fond nuk pritet të merren vendime deri në samitin e NATO-s që do të mbahet në korrik në Uashington të Shteteve të Bashkuara.



Tërmet vdekjeprurës në Tajvan



TAIPEI, 3 PRILL - Një tërmet me fuqi prej 7.2 shkallësh goditi Tajvanin herët të mërkurën, duke shkaktuar ndërprerje masive të energjisë elektrike dhe shembje të pjesshme të disa ndërtesave në lindje të ishullit. Të paktën nëntë persona humbën jetën dhe më shumë se 700 mbetën të plagosur. Epiqendra e tërmetit ishte 25 kilometra larg bregut lindor të ishullit, me një thellësi prej 15.5 kilometrash. Administrata Qendrore Meteorologjike e

Tajvanit tha se tërmeti shkaktoi ndryshime në nivelet e ujit në brigjet lindore dhe lëshoi një paralajmërim për cunami, i cili u tërhoq rreth orës 11 sipas kohës lokale.

Ky ishte tërmeti më i fortë që ka goditur ishullin në 25 vjet. Të paktën 26 ndërtesa janë shembur plotësisht ose pjesërisht në të gjithë Tajvanin.

Disa banorë të Tajvanit thanë të mërkurën se tërmeti ishte një nga më të fortët që ata kanë ndier në

shumë vite.

Të dhënat e qeverisë flasin për 736 persona të plagosur dhe 77 që kanë mbetur të bllokuar. Tërmeti dhe pasgoditjet shkaktuan 24 rrëshqitje dhe dëmtime në 35 rrugë, ura dhe tunele.

Tërmeti më i rëndë në Tajvan goditi më 21 shtator të vitit 1999, me një fuqi prej 7.7 shkallësh, duke lënë pas vetes 2 400 të vdekur, rreth 100 mijë të plagosur dhe duke shkatërruar mijëra ndërtesa.

Zgjedhjet presidenciale 2024, krimi ndër shqetësimet kryesore për votuesit amerikanë

WASHINGTON, 3 PRILL - Krimi është një ndër çështjet kryesore për votuesit amerikanë ndërsa afrojnë zgjedhjet presidenciale të nëntorit. Korrespondenti i "Zërit të Amerikës", Scott Stearns, i ka hedhur një vështrim mënyrës se si dy kandidatët kryesorë për president, demokrati Joe Biden dhe republikani Donald Trump po i trajtojnë shqetësimet e votuesve amerikanë.

Krimi ishte ndër çështjet kryesore në mendjen e votuesve në zgjedhjet paraprake një ditë më parë në Nju-Jork, ndërsa dy kandidatët kryesorë, demokrati Joe Biden dhe republikani Donald Trump pritet të përballen në zgjedhjet presidenciale të nëntorit.

Njujorkezja Goldalee, e cila i kërkoi "Zërit të Amerikës" që të mos e filmonte fytyrën e saj, thotë se ndihet më pak e sigurt. "Ekziston një energji dhe një aktivitet që nuk e kishim më parë, si me ata që mund të bëjnë krime ashtu edhe me njerëz që mund të

kenë frikë nga individët që bëjnë krime".

Votuesja Amy Pellettieri thotë se shqetësimet rreth krimit e bëjnë atë të tregohet më e kujdesshme. "Ndihehem shumë e sigurt në metro. E di që krimi është në rritje, e shoh në lajme, por nuk më ka rënë rasti të përballem. E di që po të tregohem e kujdesshme dhe të shmang situata që mund të jenë të frikshme për mua, do të jem mirë".

Në këto zgjedhje, Trumpi po bën fushatë si një kandidat për "ligjin dhe rendin" me zotimin që ta forcojë policinë lokale. Javën e kaluar ai mori pjesë në funeralin e një polici të vrarë në qytetin e Nju-Jorkut. "Duhet ta ndalojmë krimin. Duhet të rikthehem te zbatimi i ligjit. Shumë gjëra duhet t'i bëjmë ndryshe sepse kjo nuk po funksionon. Kjo po ndodh shumë shpesh (vrasja e policëve)", tha Trumpi.

Një sondazh i muajit të kaluar nga organizata "Harvard CAPS-Harris" nxori në pah se votuesit



amerikanë e shohin krimin dhe drogën si ndër çështjet kryesore me të cilat përballet vendi. Ky është një shqetësim edhe më i madh se kujdesi shëndetësor, terrorizmi dhe ndryshimet klimatike, edhe pse të dhënat e fundit nga FBI-ja tregojnë se krimi i dhunshëm pësoi rënie vitin e kaluar në të gjithë vendin, si në qytetet e mëdha ashtu edhe

në të voglat.

Presidenti Biden, nga ana e tij, thekson rënien e krimeve si dëshmi e suksesit të administratës së tij me organet e zbatimit të ligjit.

Fushata e tij po u kundërvihet sulmeve të Trumpit për krimin duke e lidhur atë me trazirat e 6 janarit 2021 në ndërtesën e Kongresit, që ndërpret procesin

shqetësimit të zgjedhjeve presidenciale, një garë ku Trumpi humbi.

Në një takim elektoral të Bidenit merrnin pjesë punonjës të rendit që ishin në ndërtesën e Kongresit ditën e trazirave. "Nuk ka nevojë të imagjinojmë ç'do të ndodhë me demokracinë dhe Kushtetutën nëse Trumpi zgjidhet përsëri. Na e ka thënë dhe na e ka treguar. Gjashtë janari do të duket si një provë e asaj që do të vijë. Nuk mund të varemi te republikanët e Trumpit për ta mbrojtur Kushtetutën, pasi ata e treguan se ishin kundër rendit dhe ligjit", thotë Aquilino Gonell, ish-polic në Kapitol.

Ndihmësit e Bidenit thonë se përgjigjja më e mirë për pretendimet e Trumpit për ligjin dhe rendin janë paditë e shumta ndaj tij për vepra penale. Republikani Trump thotë se paditë janë një ndërhyrje në zgjedhje nga një drejtësi e politizuar.

Ish-diplomati amerikan: Nuk kam dëgjuar asnjëherë që Veseli të ketë qenë i përfshirë në ndonjë arrestim

HAGË, 3 PRILL - Ish-diplomati amerikan Shaun Byrnes, në fundin e dëshmisë së tij ka dhënë disa përgjigje në pyetjet e avokatëve të krerëve të UÇK-së. Në pyetjen e Ben Emmersonit lidhur me emrin e Kadri Veselit, ai tha se asnjëherë nuk ka dëgjuar që Veseli të ketë qenë i përfshirë në ndonjë arrestim, ose të ketë pasur dijeni për këto ndodhi. "Ju keni thënë në dëshminë tuaj, keni folur për pjesëtarë të ndryshëm të Shtabit të

Përgjithshëm, dhe persona pranë Shtabit të Përgjithshëm si rasti me Sabit Gecin që ka qenë në pozicion të lartë informativ ose inteligjencën dhe rolet përkatëse të këtyre personave. Apo në përgjimet që janë kapur, keni dëgjuar ndonjëherë, keni parë ndonjë gjë, që Kadri Veseli të ketë qenë i përfshirë në ndonjë arrestim apo në negociatat për lirin e ndonjë personi, apo të ketë qenë në dijeni për këto informata?",

pyeti Ben Emmerson. "Unë nuk e di se ku ka qenë në periudhën deri më 13 janar, por e di që nuk ka qenë në Kosovë", tha dëshmitari për Veselin. Pas përfundimit të dëshmisë së Byrnes, dëshmitari e ka vazhduar dëshmitari i 54-t i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, i cili mban kodin W04739 në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. (Betimi për Drejtësi).




Osmani pret në takim Bouyxin, diskutojnë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim Bertrand Bouyx, kryetar i Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, njëkohësisht deputet në Kuvendin Kombëtar të Francës. Në takim u diskutua për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, me ç'rast falënderoi Bouyx për liderhipin dhe mbështetjen e tij për Kosovën në Komitetin për Çështje Politike dhe Demokraci, i cili me shumicë votoi për ta çuar përpara anëtarësimin e Kosovës për votim në Asamblenë Parlamentare. Presidentja Osmani theksoi se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e



Evropës do të ishte hap i rëndësishëm për fuqizimin dhe avancimin e mëtejshëm të të drejtave

të njeriut nëpërmjet mekanizmave që i ofron Këshilli e të cilat do të shërbenin si mekanizëm shtesë për

mbrojtjen e garantimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Në këtë frymë, presidentja Osmani tha se qasja në institucionet dhe mekanizmat e Këshillit të Evropës, siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është mbi të gjitha në interes të qytetarëve të Kosovës, pa dallim.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen dhe ritheksoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme të Francës në këtë drejtim, ndërsa ka shfaqur besim që anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të vlerësohet pozitivisht nga deputetët e shteteve anëtare në Asamblenë Parlamentare.

Tutje, presidentja Osmani ka shprehur përkushtimin e plotë të vazhdohet puna e përbashkët me shtete mike e aleate për ta avancuar tutje këtë proces drejt finalizimit të suksesshëm të tij.

Shtatëfishohet numri i zyrtarëve që nuk deklaruan pasurinë



PRISHTINË, 3 PRILL - Për rreth shtatë herë është rritur numri i zyrtarëve publikë që nuk e kanë bërë deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit në krahasim me vitin e kaluar. Afro 200 zyrtarë nuk i janë përgjigjur pozitivisht thirrjes për deklarimin e pasurisë, nga 8 mijë sa ishin të obliguar. Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Yll Buleshkaj, thotë se përkundër që ka pasur lehtësime në procesin e deklarimit, numri i zyrtarëve që nuk e kanë kryer këtë obligim është rritur në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë vitit të kaluar kanë qenë mbi 30 persona

që nuk e kanë deklaruar pasurinë, derisa tregon se këtë vit ky numër shkon në 200. Për "KosovaPress", Buleshkaj potencon se për të gjithë ata të cilët nuk u janë përgjigjur pozitivisht kësaj thirrjeje, ligji parasheh shqiptimin e gjobave, duke filluar me ndaljen 30 për qind të pagës mujore e deri në kallëzim penal tek institucionet e drejtësisë. "Kanë qenë afërsisht rreth 8 mijë zyrtarë të cilët kanë qenë në këtë fazë të obliguar ta kryejnë deklarimin e pasurisë. Nga këta janë 198 sipas statistikave të cilët nuk e kanë kryer këtë obligim në kohë. Ky numër,

edhe pse është caq i madh, ka mundësi që të bie sepse ende nuk kemi pastruar listat. Ka mundësi që ndonjë nga ta si pjesë të pozitave të tjera e ka deklaruar më herët pasurinë. Por, afërsisht ky është numri. Kemi një përgjigje të mirë, mbi 99 për qind e kanë kryer obligimin. Por, prapë kemi një numër i cili nuk është i vogël, të cilët nuk e kanë kryer këtë obligim ligjor. Hapi i radhës është pastrimi i listave, pastaj kontaktojmë me të gjithë këta zyrtarë, marrim shpjegimet e tyre dhe si fund vendosim për gjoba", ka thënë Buleshkaj.

Një grua nga Podujeva lind katërnjakë në QKUK

PRISHTINË, 3 PRILL - Në Klinikën Obstetrike - Gjinekologjike, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, një nënë nga Podujeva ka lindur katërnjakë. Nëna me inicialet D. S., 26-

vjeçare, ka lindur me operacion, në kujdes shëndetësor të mjekëve, mamive dhe infermierëve. Tre fëmijë janë të gjinisë mashkullore dhe një e gjinisë femërore. Nëna bashkë me

fëmijët janë në gjendje të mirë shëndetësore. Tani fëmijët janë nën përkujdesje të stafit mjekësor në Klinikën e Neonatologjisë, ku janë duke marrë trajtimet e nevojshme.





GNK: Kosova të bashkëpunojë me KFOR-in për çmilitarizim të veriut dhe të marrë hapa për vetëqeverisje të serbëve

PRISHTINË, 3 PRILL - Kosova, Serbia dhe palët e tjera të jashtme duhet të fokusohen në shmangie të rrezikut afatshkurtër të dhunës në veri të Kosovës, më pas të analizojnë mënyra për të garantuar stabilitet afatgjatë.

Kështu është thënë në raportin më të ri të Grupit Ndërkombëtar të Krizave - organizatë që harton analiza të pavarura dhe këshilla për parandalim, zgjidhje dhe menaxhim të konflikteve - të publikuar më 2 prill.

Në raportin me titull 'Veriu i Kosovës: pohimi i sovranitetit mes besnikërive të ndara', dedikuar marrëdhënieve Kosovë - Serbi, me fokus në veriun e Kosovës dhe zhvillimet atje, Kosovës i sugjerohet të bashkëpunojë me forcat paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë [KFOR] "për të çmilitarizuar veriun". "Kosova duhet t'i tërheqë njësitet speciale të Policisë prej rajoneve me shumicë serbe dhe derisa ta bëjë atë, t'i dislokojë ato me masë dhe vetëm në koordinim me paqeruajtësit e KFOR-it, të cilët banorët e veriut i shohin si më të besueshëm, marrë parasysh përkushtimin e tyre për neutralitet".

Në prill të vitit 2013 Kosova dhe Serbia e kanë nënshkruar atë që

njihet si "Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve" - e njohur si Marrëveshja e Brukselit.

Aty përmendet se do të ketë një komandant rajonal të policisë për katër komunat me shumicë serbe - Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - i cili duhet të jetë serb, shtetas i Kosovës.

Por, në asnjë nga pikat e kësaj marrëveshjeje nuk përmendet shkuarja apo jo e njëjësive speciale të Policisë së Kosovës në veri.

Sipas raportit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, për ta rritur ndjesinë e sigurisë së Prishtinës, KFOR-i duhet t'i ndihmojë Kosovës në kontrollimin e kufirit, ta parandalojë kontrabandën e armëve të rënda dhe t'i gjejë ato që janë futur më herët.

"E Serbia duhet ta ndalojë mbështetjen për aktivitet paramilitar dhe t'i gjykojë ata që janë përfshirë në vrasjen e policit të Kosovës. Në mungesë të një zgjidhjeje politike gjithëpërfshirëse, barra do të jetë mbi Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n, për të garantuar paqe dhe për ta shmangur përshkallëzimin, derisa të arrihen kushtet për një

marrëveshje të negociuar".

Në raport, Grupi Ndërkombëtar i Krizave ka vlerësuar se Kosova është duke e fituar betejën për kontrollin e veriut, ndonëse shpresat për normalizim marrëdhëniesh në mes të Prishtinës dhe Beogradit po zbehen.

Dy palët negociojnë në Bruksel për normalizim të marrëdhënieve - me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian - qysh prej vitit 2011. Palët i kanë arritur disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar.

Në raport është thënë se "institucionet e mbetura serbe në territorin e Kosovës, të cilat i kanë mbijetuar luftës të vitit 1999 dhe pavarësisë së Kosovës më 2008, po shpërbëhen pas një operacioni paramilitar të mbështetur prej Serbisë në shtator të vitit 2023".

Në shtator të vitit të kaluar, grupe të armatosura serbe e kanë sulmuar Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit, duke e vrarë zyrtarin e Policisë së Kosovës, Afrim Bunjakun.

Më pas, në shkëmbim e sipër të zjarrit, janë vrarë tre sulmues. Kosova e akuzon shtetin e Serbisë për organizim dhe kryerje të sulmit, por Beogradi e mohon

këtë gjë.

Ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq, e ka marrë përgjegjësinë për sulmin. Ai aktualisht besohet se është i lirë në Serbi. Sipas raportit, sulmi në Banjskë e ka kthyer vëmendjen te veri i Kosovës në të mirë të Prishtinës, të paktën në sytë e Brukselit dhe Uashingtonit. Sipas analizës, sulmi "e ka krijuar një dyshim të fuqishëm që Beogradi e ka armatosur dhe trajnuar grupin paramilitar për sulmet vdekjeprurëse ndaj Policisë së Kosovës. Pa një alternativë bindëse, Serbia ka humbur shumë mbështetje që e ka fituar nga fleksibiliteti në dialogun e ndërmjetësuar të BE-së".

Në gjetjet e tjera është përmendur se pas sulmit në Banjskë, Prishtina ka përfituar prej ndryshimit të rrethanave për ta përshpejtuar integrimin e veriut dhe për t'i dëbuar institucionet e mbetura të Serbisë. "Prej perspektivës së saj, incidenti ka konfirmuar se problemi me të cilin përballlet veri janë kriminelët dhe terroristët e përkrahur prej Beogradit dhe jo serbët e thjeshtë. Ajo e ka konsideruar kërcënimin paramilitar si arsyetim për ta angazhuar policinë e armatosur rëndë në

atë zonë".

Sipas raportit, "këto janë ditë të vështira për pakicën serbe, e ardhmja e së cilës është jetike për afrim mes Beogradit dhe Prishtinës". "Për të mbetur komunitet që mund të vetëqeveriset, atij i duhet qasje e vazhdueshme në institucionet e Serbisë, sidomos në fushën e edukimit dhe shëndetësisë, plus mbështetja financiare. Atij i duhet edhe siguria, që mund ta fitojë me kthimin e serbëve në Policinë e Kosovës, prej së cilës serbët janë tërhequr në nëntor të vitit 2022".

Grupi i sugjeron Kosovës edhe të marrë "hapa kredibilë drejt garantimit të vetëqeverisjes për pakicën serbe në veri. Zgjedhjet e reja duhet të mbahen, bashkë me dhënie fund të bojkotit të serbëve të veriut ndaj institucioneve qeveritare".

Raporti u është referuar zgjedhjeve të reja për katër kryetarët e komunave në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - të cilat aktualisht i udhëheqin katër shqiptarë. Ata i kanë fituar këto pozita në zgjedhjet e mbajtura në prill të vitit të kaluar në katër komunat veriore të cilat i ka bojkotuar popullsia serbe në veri.

Aktualisht kanë nisur procedurat

Nga 3 prilli me rregulla dhe dënime të reja trafiku në Kosovë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 PRILL - Nga 3 prilli në Kosovë ka nisur së zbatuari Ligji i ri për rregullat e trafikut rrugor, i cili ka për qëllim rritjen e sigurisë rrugore dhe mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së pjesëmarrësve në trafik, dhe parasheh masa më të ashpra ndëshkuese për kundërvajtësit. Me ligjin e ri është paraparë gjobë prej 150 eurosh për ata që nuk e vendosin rripin e sigurisë si dhe gjoba të larta për përdoruesit e telefonave gjatë vozitjes. Sipas zyrtarëve të policisë, shpërqendrim më të madh te

shoferët në trafik është përdorimi i telefonit dhe të pajisjeve të tjera elektronike.

Mosvendosja e rripit të sigurisë, 150 euro.

Përdorimi i telefonit gjatë ngasjes 100 euro, 1 pikë negative (për herë të parë); 200 euro, ndalim vozitjeje për 3 muaj, 2 pikë negative (për herë të dytë); 500 euro, ndalim vozitjeje për 6 muaj, 3 pikë negative (pas herës së dytë).

Tejkalimi i shpejtësisë jashtë vendbanimit, 20 euro për tejkallim shpejtësie për 10-20 km/h; 40 euro për tejkallim shpejtësie për 20-30 km/h; 150 euro, 2 pikë negative për tejkallim

shpejtësie për 30-50 km/h; 300 euro, ndalim vozitjeje për 3 muaj, 3 pikë negative për tejkallim shpejtësie për 50-100 km/h; 500 euro, ndalim vozitjeje për 6 muaj, 5 pikë negative për tejkallim shpejtësie për mbi 100 km/h.

Vozitja e mjetit me regjistrim të skaduar, 200 euro, konfiskim targash për personin fizik (kur regjistrimi ka skaduar për jo më gjatë se 30 ditë); 500 euro, konfiskim targash për personin juridik (kur regjistrimi ka skaduar për jo më gjatë se 30 ditë); Konfiskim i mjetit nëse regjistrimi ka skaduar për më shumë se 30 ditë.

Tejkalimi i shpejtësisë brenda

vendbanimit, 20 euro për tejkallim shpejtësie për 5-10 km/h; 40 euro për tejkallim shpejtësie për 10-20 km/h; 60 euro për tejkallim shpejtësie për 20-30 km/h; 200 euro, ndalim vozitjeje për 3 muaj, 3 pikë negative për tejkallim shpejtësie për 30-50 km/h; 300 euro, ndalim vozitjeje për 6 muaj, 3 pikë negative për tejkallim shpejtësie për 50-70 km/h; 400 euro, ndalim vozitjeje për 9 muaj, 4 pikë negative për tejkallim shpejtësie për 70-100 km/h; 500 euro, ndalim vozitjeje për 12 muaj, 5 pikë negative për tejkallim shpejtësie për mbi 100 km/h. Një ditë më parë në ambientet e

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës në Prishtinë, drejtori i Departamentit për Rend Publik, nënkolonel Arbnesht Ajvazi dhe drejtori i Divizionit të Komunikacionit Rrugor nënkolonel, Jeton Rexhepi,

mbajtën takim me zëvendës drejtorët rajonalë të PK-së, komandantët e Njësive të Trafikut, përfshirë Njësinë për Kontroll në Autostrada, lidhur me implementimin e Ligjit të ri për rregullat e trafikut rrugor.

Në fokus të takimit ishte implementimi i këtij ligji dhe angazhimet policore në funksion të menaxhimit dhe kontrollit sa më efektiv në trafikun rrugor.



për shkarkim të kryetarëve aktualë, çka do të mund të hapë rrugën për zgjedhje të reja.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, ndonëse ka bojkotuar zgjedhjet e prillit, ka thënë javë më parë se është e gatshme të marrë pjesë në procesin e ri zgjedhor. Kur janë përmendur marrëveshjet, në raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave janë vlerësuar edhe dy aspektet më problematike në dialogun Kosovë - Serbi dhe normalizimin e raporteve mes tyre.

Në anën e Kosovës është përmendur formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Të martën, më 2 prill, edhe zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka thënë se Kosova duhet ta zbatojë urgjentisht detyrimin shumëvjeçar për themelimin e një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe në vend dhe ka paralajmëruar se ajo do të

përballet me pasojë në rrugën e saj drejt BE-së, nëse dështon ta bëjë këtë.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Por, më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Në fund të vitit të kaluar bashkësia ndërkombëtare ua ka paraqitur palëve një draft për statutin që do të kishte ky Asociacion. Palët, fillimisht, patën thënë se e kanë pranuar atë, por nuk kanë bërë asnjë hap përpara.

Në një intervistë për Radion Evropë e Lirë më 19 mars, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se nuk e ka pranuar këtë draft-statut. "Një tjetër prioritet është përmbushja e nevojave të pakicës së serbëve të Kosovës - me apo pa një kornizë zyrtare për autonomi.

Banorët e veriut varen prej shkollave, universiteteve dhe qendrave shëndetësore që funksionojnë në kuadër të sistemit të Serbisë. Shumica e banorëve paguhen direkt ose indirekt nga Beogradi dhe pranojnë ndihma në dinarë përmes një sistemi të zyrave postare dhe bankave që Kosova synon t'i mbyllë", është thënë në raport.

Më 1 shkurt, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka nisur të zbatojë një rregullore të re që parasheh euron si valutën e vetme për kryerje të pagesave me para të gatshme.

Kështu është pamundësuar përdorimi i dinarit.

Serbia deklaroi se ndan ndihmë në vlerë të miliona eurove për serbët e Kosovës dhe ua paguan atyre rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë në dinarë.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian i kanë kërkuar Kosovës ta shtyjë zbatimin e rregullores së BQK-së

me arsyetimin se është fuqizuar shumë shpejt, pa ofruar alternativa të duhura për serbët që marrin dinarë.

Disa serbë të Kosovës, me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë në javët e fundit, e kanë pranuar se u është vështirësuar jeta pas pamundësimin për të marrë dinarë.

Serbia i ka instaluar disa bankomate në disa pika kufitare me Kosovën, për t'ia mundësuar komunitetit serb në Kosovë që të marrë dinarë. "Diskriminimi etnik dhe barrierat gjuhësore i mbajnë shumë serbë të Kosovës larg nga tregu i punës. Nëse e humbin qasjen në punët serbe dhe përfitimet, ata do të emigrojnë. BE-ja dhe ShBA-ja duhet t'i kërkojnë Kosovës ta mundësojë vazhdimësinë e këtyre shërbimeve serbe. Ata duhet t'i kërkojnë Prishtinës t'i japë fund ndalesës në importet e ushqimeve dhe ilaçeve prej Serbisë dhe për çështjen e dinarit. Për të gjitha këto, Kosova

duhet ta ndjekë qëndrimin e ShBA-së dhe BE-së", është thënë mes tjerash në raport.

Në anën e Serbisë është përmendur njohja de facto e Kosovës. "Njohja de facto nënkupton që Kosova të trajtohet si shtet i pavarur pa një deklaratë zyrtare [nga Serbia] dhe ajo t'ua mundësojë shteteve të tjera dhe trupave ndërkombëtare sikurse Kombet e Bashkuara që ta njohin dhe ta pranojnë atë si anëtare. Serbia është e gatshme të merret me Kosovën direkt, por është e vendosur ta mbajë të hapur çështjen e statusit të saj" është thënë në raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave.

Kosova e ka shpallur pavarësinë në vitin 2008.

Shtetësia e saj është njohur prej 117 shteteve, përfshirë ShBA-së dhe shumicës së vendeve anëtare të BE-së. Mirëpo, Serbia vazhdon të mos e njohë shtetin e Kosovës dhe tenton ta pengojë anëtarësimin e saj në shumë organizata ndërkombëtare.

Vizitë normale në moment jonormal dhe me prapavijë jonormale



Shkruan: Milazim
KRASNIQI

Vizita e Albin Kurtit në Leposaviq është vizitë e kryeministrit të Kosovës në një qytet të Kosovës, prandaj kushdo që shprehë çudi ose ekzaltim, e ka gabim. Bile është për keqardhje pse për gjithë këto vite nuk është arritur në një normalitet, ku edhe vizitat e zyrtarëve të lartë shtetërorë, do të ishin normale. Por, as jonormaliteti i rrënjësor për kaq

vite, një vizitë të kryeministrit të Kosovës në një qytet të Kosovës, nuk e bën jonormale. Ata qytetarë financohen nga buxheti i Kosovës dhe janë të obliguar të respektojnë ligjet e Kosovës. Pra, parimisht vizita/vizitat nuk duhet të shihen as si sukses, as si problem.

Me gjasë problem paraqet momenti, prapavija, motivi i vizitës së sotme të Kurtit në Leposaviq. Pse? Sepse në takimin e nesërm në Bruksel për dinarin, mund të bëhen lëshime lidhur me legalizimin dhe qarkullimin e dinarit në Kosovë. Prandaj vizita mund të jetë një tentativë për të rritur kreditë e Kurtit, për ta maskuar disi kompromisin për dinarin. E dyta, meqë më 21 prill në

komunat e veriut mbahet procesi për largimin e kryetarëve shqiptarë, vizita mund të jetë edhe si një shprehje triumfalizmi, para se të ndërpritet mandati e katër kot-kryetarëve. Dhe e gjithë kjo pastaj mund të paktohet si parapërgatitje për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Kosovë, meqë laku për Asociacionin është shtrënguar shumë rreth qafës së qeverisë Kurti. Deklarata e djeshme e Peter Stanos thotë se për BE-në formimi i Asociacionit është çështje urgjente. Meqë qenka urgjente, e vetmja mënyrë për ta shtyrë është shkuarja në zgjedhje. Ndërsa shkuarja në zgjedhje ka lazëm për propagandë, pseudopatriotizëm dhe xhurrullë. Kurti faktikisht e ka nisur fushatën për zgjedhje.

Mirëpo, Kurti me veprimet dhe propagandën e tij duhet ta ketë para sysh edhe rrezikun e konfliktit të veri. Siç ka pohuar admiral Xhejms Stavridis, Rusia po e shtyn Serbinë për një konflikt në Kosovë e në BeH. E tash, nëse Ruisë po i konvenon një konflikt në Kosovë, e sigurt është që Kosovës dhe NATO-s nuk i konvenon asnjë konflikt këtu. Prandaj edhe veprimet e qeverisë Kurti duhet ta shmangin konfliktin, e jo t'i krijojnë alibi konfliktit, i cili i duhet Ruisë. Nga analiza e detajeve të deklaratave e veprimeve të ditëve të fundit, fitohet përshtypja se qeveria Kurti ose nuk ka aftësi të bëjë analiza, ose i bën analizat gabimisht, ose po e provokon konfliktin qëllimisht. Pse? Nëse

është e saktë deklarata e ministrit të brendshëm, se në afërsi të Kopaonikut po përgatiten trupa serbe për sulm ndaj Kosovës, atëherë në këtë moment e përballë atij rreziku, nuk ka vend për vizitë të Kurtit në Leposaviq, meqë ajo vizitë për serbët llogaritet si provokim. Pra vizita vetëm sa mund t'i shtyjë serbët e Leposaviqit në përqaftim të planeve të Radojçiqit, Vuçiqit e Putinit. Vërtet ka shumë paqartësi, pse bëhen disa veprime, që vetëm e komplikojnë gjendjen edhe ashtu të rëndë. Kosovës i duhet normaliteti. Kur të arrihet normaliteti edhe vizitat në veri bëhen krejtësisht normale, në çdo moment që të zhvillohen. (3 prill 2024)

Kurti viziton komunat në veri: Institucionet tona duhet t'i trajtojnë qytetarët në mënyrë të barabartë



PRISHTINË, 3 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i vizitoi të mërkurën komunat me shumicë serbe në veri të vendit, Mitrovicën e Veriut, Leposaviqin, Zveçanin dhe Zubin Potokun për, siç tha, të biseduar me udhëheqësit vendës për përmirësimin e marrëdhënieve me qytetarët pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike apo fetare. "Ne jemi kundër ndarjes së shoqërisë. Ne jemi për barazi. Institucionet tona duhet t'i trajtojnë qytetarët në mënyrë të barabartë dhe t'u mundësojnë qasje në sistemin institucional", tha Kurti pas takimit me kryetarin e Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq.

Kryetarët shqiptarë erdhën në pushtet në komunat në veri të Kosovës në fillim të vitit të kaluar përmes zgjedhjeve të cilat u bojkotuan nga popullata serbe dhe partia më e madhe serbe në

Kosovë, Lista Serbe. Kjo çështje ngriti edhe tensionet etnike në maj të vitit të kaluar, të cilat kulmuan më 24 shtator 2023, kur një grup i serbëve të armatosur e sulmuan Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit. Por, ka kohë që kanë nisur procedurat për shkarkim të kryetarëve të tanishëm, çka do të mund të hapet rruga për zgjedhje të reja në këto komuna.

Kurti ka thënë se gjatë vizitës së tij në veri e ka vizituar edhe vendin në Banjskë "ku ka rënë në pritë" Afrim Bunjaku, rreshteri policor i vrarë në atë sulm.

Për vizitën e Kurtit në komunat e veriut u raportua fillimisht nga Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit.

Lista tha në një komunikatë për media se vizita e kryeministrit Kurti në komunat e veriut ka për qëllim "destabilizimin e situatës

në terren dhe shkaktimin e tensioneve". "Është më se e qartë se me ardhjen e tij ai donte ta provokonte reagimin e popullit serb dhe të paraqitej si viktimë për të fituar disa pikë politike, apo vota për zgjedhjet e ardhshme", tha Lista.

Nga ana tjetër, kryeministri i Kosovës nënvizoi se "tendencat për destabilizimin e Kosovës vijnë nga ana tjetër", duke iu referuar Serbisë.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç, ka reaguar me pretendimet se Kurti, duke shkuar në Leposaviq dhe Zubin Potok, "ka vendosur të ngrejë tensione të reja" në veri të Kosovës vetëm një ditë para vazhdimin të dialogut në Bruksel. "Kurti nuk ka çfarë të kërkojë në veri të Kosovës dhe Metohisë". Nuk është i mirëpritur. Veprimi i Kurtit shkaktoi revoltë dhe

indinjatë te serbët të cilët e shohin atë si një pushtues që i keqtrajton çdo ditë", tha Petkoviç.

Gjatë vizitës së tij në veri të Kosovës, Kurti vendosi lule edhe në pllakën përkujtimore të ish-policit të Kosovës, Enver Zymberi, në Zubin Potok, ku ishte vrarë në vitin 2011, nga persona ende të pidentifikuar. Ai u vra gjatë një aksioni të organizuar nga Qeveria e Kosovës për marrjen e kontrollit të pikave kufitare 1 dhe 31 në Jarinjë dhe Bërnjak.

Duke folur për takimin e ardhshëm në kuadër të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, ku duhet gjetur zgjidhja për pagesën e beneficioneve për serbët në Kosovë nga buxheti i Serbisë, Kurti ka ripërsëritur qëndrimin se vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës nuk ndalon dinarin, por përcakton euron si valutë të

vetme.

Serbia u paguan të ardhura të ndryshme pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë prej vitësh, por kjo është bërë e vështirë nga 1 shkurti, kur hyri në fuqi vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës, i cili e ndalon përdorimin e dinarit për pagesa me para të gatshme.

Kurti ka vlerësuar se Serbia insiston t'i paguajë paratë "në para të gatshme sepse u paguan disa njerëzve që nuk duhet", duke mos specifikuar për cilët persona bëhet fjalë. "Nuk kam asgjë kundër faktit që mjekët, profesorët, mësimdhënësit marrin mjete, por duket se shqetësimi kryesor i Beogradit është që disa persona të tjerë të mos marrin para të gatshme", tha Kurti.

Ai shtoi se rregullorja e BQK-së është miratuar për të pasur një pasqyrë të qarkullimit të parave.

ATK-ja: 25.8 milionë euro më shumë të hyra tatimore se në tre muajt e parë të vitit të kaluar


EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 PRILL - Administrata Tatimore e Kosovës përmes një njoftimi për medie ka bërë me dije se mbledhja e të hyrave për periudhën janar - mars 2024 kap shifrat prej 236.2 milionë eurosh, ndërsa nëse krahasohen me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rritje për 25.8 milionë euro apo 12.2%. "Institucioni kryesor për mbushjen e arkës së shtetit vazhdon të performojë në mënyrë të shkëlqyer në drejtim të rritjes së mbledhjes së të hyrave tatimore, si dhe në trajtimin e dukurive të cilat dëmtojnë

ekonominë dhe konkurrencën e drejtë në treg. Profesionalizmi, implementimi i legjislacionit tatimor, llogaridhënia, rritja e shërbimeve digjitale, partneriteti me qytetarë në raportimin e rasteve korruptive, janë disa nga faktorët të cilët kanë ndikuar në rritjen e trendit të të hyrave tatimore dhe uljen e statistikave të evazionit fiskal. Mbledhja e të hyrave për periudhën janar - mars 2024 kap shifrat prej 236.2 milionë eurosh, ndërsa nëse i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi rritje për 25.8 milionë euro apo 12.2%", ka njoftuar ATK-ja. Sipas këtij njoftimi, mjedisi në të

cilin ATK-ja vepron është kompleks dhe vazhdimisht pëson ndryshime, andaj kjo e detyron Administratën Tatimore të reagojë paanshëm në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. "Forcimi i përbushjes vullnetare në të gjitha segmentet e tatimpaguesve vazhdon të mbetet prioritet kryesor, duke u siguruar që tatimpaguesit ta paguajnë shumën e saktë tatimore dhe duke ndërmarrë veprimet e duhura ndaj tatimpaguesve mospërbushës. ATK-ja falënderon të gjithë tatimpaguesit të cilët i kryejnë saktë dhe me kohë obligimet tatimore!", ka njoftuar ATK-ja.



Pagat e ulëta, OShP-ja përballet me mungesë të stafit

PRISHTINË, 3 PRILL - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga kryetari Armend Muja, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës. Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe u miratua raporti me rekomandime të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë. Komisioni, po ashtu, miratoi raportin plotësues për Projektkodin Doganor dhe shqyrtoi raportin vjetor të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2023. Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Vjosa Gradinaj-



Mexhuani, duke prezantuar raportin vjetor të punës, tha se gjatë vitit 2023 OShP-ja ka pranuar gjithsej 1 071 lëndë, ku

354 prej tyre janë kthyer në rivlerësim, ndërsa 85 lëndë janë anuluar krejtësisht. Kryetarja e OShP-së tha se ka

vonesa në trajtimin e lëndëve në këtë institucion, pasi që, sipas saj, OShP-ja po përballet me mungesë të stafit.

Gradinaj-Mexhuani shtoi se për shkak të koeficientit të ulët të pagave shumë nga punëtorët e OShP-së kanë dhënë dorëheqje nga puna, ndërsa stafi aktual është duke u përballur me fluks të shtuar të punës në mënyrë që lëndët të trajtohen në afatin e paraparë. Pas prezantimit të raportit, deputetët shtruan pyetje për kryetaren e OShP-së dhe bashkëpunëtorët e saj, për shumë çështje që lidhen me veprimtarinë e këtij institucioni. Në fund Komisioni vendosi që në një mbledhje të radhës përfaqësuesit e OShP-së të ftohen në raportim për raportin vjetor financiar, ndërsa për mbledhjen e ardhshme u shty shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitet 2022 dhe 2023.

Ministria e Financave: Dikush po tenton t'i mashtrojë pensionistët me premtime për përfitime monetare

PRISHTINË, 3 PRILL - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se ditët e fundit zyrat e pensioneve janë duke i frekuentuar një numër i konsiderueshëm i pensionistëve me kërkesa për vërtetime apo vendime që dëshmojnë se të njëjtit janë përfitues të pensioneve. MFPT-ja ka njoftuar se sipas informatave që kanë siguruar, persona të papërgjegjshëm janë duke kërkuar dokumentacion dhe autorizim nga pensionistët me premtimin se do t'u sigurojnë përfitimin e shumave të caktuara monetare. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve njofton të gjithë qytetarët dhe përfituesit e skemave pensionale që informatat e qarkulluara nuk janë të sakta dhe konsistojnë në

informatë të rremë me tendencë të mashtimit. "Andaj, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve fton qytetarët të kenë kujdes nga informatat e rreme që po qarkullojnë këto ditë që për theks kanë keqinformimin e përfituesve të skemave pensionale në Kosovë. Po ashtu, ftojme përfituesit e skemave pensionale që të kenë kujdes lidhur me dokumentacionin dhe autorizimin e bërë të palët e treta, meqë mund të cenohet privatësia e të dhënave të tyre", ka njoftuar MFPT-ja. Po ashtu, lidhur me skemat pensionale dhe përcaktimin e shumës së pensioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kërkon nga të gjithë përfituesit e skemave pensionale që t'i ndjekin vetëm njoftimet zyrtare të MFPT-së dhe Qeverisë



së Republikës së Kosovës, ndërsa të kursehen nga njoftimet dhe shërbimet e tjera jozyrtare të cilat mund të bëhen për interesa private të personave të caktuar.

"Ne do të sigurohemi që të shpërndajmë në kohë të gjitha informacionet e sakta lidhur me pensionet dhe çështjet me interes për pensionistët. Andaj, ju lutem

t'u referoheni njoftimeve të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve si kanali i vetëm zyrtar në lidhje me këtë fushë", ka njoftuar Ministria e Financave.

Alexey Navalny, sfidant deri në frymën e fundit



Në një pjesë të shkëputur nga një libër i ri, i burgosuri politik Alexei Navalny, i cili ndërroi jetë në qeli në Rusi, zbulon mendimet e tij mbi jetën, familjen dhe vendin që e quante shtëpinë e tij

Gjashtë muaj përpara se të ndërronte jetë në një koloni penale të Arktikut, udhëheqësi opozitar rus Alexei Navalny shkruante për shpresat që kishte për vendin e tij, dashurinë për familjen dhe letërsinë, si dhe maksimën që i kish dhënë formë mënyrës së tij të menduarit: “Unë besoj se Rusia do të jetë e lumtur dhe e lirë”, thoshte ai. “Dhe unë nuk besoj tek vdekja”. Kritiku i kahershëm i presidentit rus, Vladimir Putin, i ndau mendimet e tij në përgjigje të një pyetësori që u dërgohej të burgosurve politikë në të gjithë Rusinë nga Boris Akunin, një prej shkrimtarëve më popullorë të vendit, prej kohësh në mërgim. Ai i botoi përgjigjet e të burgosurve në një libër elektronik në tetor të vitit që kaloi. Në janar, Rusia e shpalli Akuninin agjent të huaj dhe ai iu shtua një liste terroristësh dhe ekstremistësh, për shkak të kundërshtimit të tij ndaj pushtimit rus të Ukrainës. Ja pyetjet dhe përgjigjet e Navalny.

Kush je ti?

Nga autoritetet e burgut, dëgjoj vazhdimisht këtë frazë: “Hmmm duket se qenke në humor të mirë sot”. Kështu që, po e

përmbledh kështu: Unë jam një i burgosur politik, të cilit i mungon shumë familja e tij, puna dhe kolegët, por që vazhdon të mbajë lart humorin. Jam, gjithashtu, një leximtar. Pjesën më të madhe të ditës e kaloj me një libër në duar.

Në çfarë beson?

Besoj në Zot dhe në shkencë. Unë mendoj se jetojmë në një Univers jo të parapërcaktuar dhe se ne kemi vullnet të lirë. Unë besoj se ne nuk jemi vetëm në këtë Univers. Unë besoj se veprimet dhe punët tona do të vlerësohen një ditë. Unë besoj në dashurinë e vërtetë. Unë besoj se Rusia do të jetë e lumtur dhe e lirë. Dhe nuk besoj tek vdekja.

Kur merr vendimet më të rëndësishme, beson tek arsyeja, apo instikti?

Nuk ka kontradiktë këtu, është një alternativë e rreme. Evolucionin na ka bërë që të mos mendojmë shumë thellë dhe shumë gjatë, kur shohim që kemi një gjarpër në shtrat. Nga ana tjetër, nuk marrim vendime të atypëratyshme për të ndërtuar një shtëpi ku nuk mund të hyjnë gjarpërinjtë. Është një libër i mrekullueshëm për këtë, i

quajtur “Të menduarit shpejt dhe ngadalë”, me autor Daniel Kahneman. Jua rekomandoj.

Cila është gjëja më kryesore në jetë?

Të jesh i dobishëm për shoqërinë dhe të mbetesh një njeri i mirë.

Cila gjë të sjell më shumë gëzim?

Momentet e thjeshta familjare. Si për shembull kur udhëtojmë të gjithë së bashku me makinë. Njëri prej nesh fillon të këndojë, dhe të gjithë të tjerët i bashkohemi. Dhe nuk ndalemi pa kënduar disa këngë resht. Dhe dashuria e lumturia rrjedhin natyrshëm.

Çfarë të trishton më shumë?

Mungesa e gatishmërisë së shumë njerëzve për të menduar, moskuptimi prej tyre i marrëdhënieve shkak-pasojë. Çdo herë që dikush më thotë: “Korrupsioni nuk ndikon mbi jetën time”, apo “këta që janë në pushtet kanë mbaruar punë me vjedhjet, por nëse vijnë të tjerë, ata do të fillojnë të vjedhin nga fillimi”. Mendoj: Si ka mundësi që qindra-miliona vite evolucion u kanë dhënë këtyre njerëzve një mendje – dhe ata nuk e përdorin?

Cila është ajo gjë që sjell të keqen më të madhe për njeriun dhe njerëzimin?

Gjithçka që i duhet të keqes për të triumfuar, është inaktiviteti i

njerëzve të mirë. Është një frazë që i është atribuar shumëkujt, por askush nuk e di saktësisht se kush e ka thënë. Është shumë e saktë. Hipokrizia e neutralitetit, “apoliticizmi”, fshehja e dembelizmit, burracakëria dhe ligësia janë arsyeja përse një grusht të ligjsh të organizuar kanë sunduar mbi miliona njerëz përgjatë historisë.

Dhe dobia më e madhe?

Angazhimi në betejën e të mirës kundër neutrales.

Cila formë arti ka më shumë ndikim mbi ty?

E dashuroj letërsinë dhe mendoj se di diçka për të. Më pëlqejnë filmat, muzika dhe arkitektura, por nuk di shumë për to. Sa për pjesën tjetër të arteve, po jua them në mënyrë diplomatike: “I trajtoj me respekt”. Letërsia ka më shumë ndikim, se sa çdo formë tjetër arti. Në fund të fundit, funksionon përmes imagjinatës tënde. E çfarë mund të jetë më e fortë se ajo?

A ke një maksimë të preferuar?

Nuk kam. Kam një maksimë e cila përmban fjalën “maksimë”. “Vepra në mënyrë të tillë që, maksima e veprimit tënd të shndërrohet në një rregull sjelljeje universale”. Është një prej formulimeve të Kantit mbi ligjin moral. Është e ngjashme me rregullin e artë të Biblës (“Bëju të tjerëve

atë që do të doje të të bënin ty”). Versioni biblik është më i mëshirshëm. Versioni i Kantit është, mendoj unë, më i përgjegjshëm, dhe unë zgjedh atë. Ndjekja e secilit prej këtyre rregullave është e vështirë, por mendoj se duhet të përpiqemi ta bëjmë.

Nga librat që ke lexuar, cili është më i rëndësishmi?

“Aventurat e Hakëlberri Finit”. Kur e lexova, në moshën 10 apo 11 vjeç, kuptova se librat mund të ishin jo vetëm të mërziqshëm dhe të dobishëm, por edhe të pamundur për t’u hequr nga dora dhe të të bënin të qeshje pas çdo faqeje. Kështu që nisa të lexoja. Gjithmonë ndjej shumë keqardhje për ata që nuk lexojnë libra. Me siguri, në fëmijërinë e tyre nuk kanë patur fatin t’u binte në duar libri i duhur.

A ke një personazh që e ke si shembull?

Ka patur dhe ka shumë njerëz të mirë – të guximshëm, të zotë, të sjellshëm dhe inteligjentë – dhe nuk mund të zgjedh vetëm një.

Çfarë është Rusia për ty sot?

Një vend ku kuptoj gjithkënd dhe ndihem në shtëpi. Një vend ku flitet gjuha ime dhe jeton populli im. Jam në gjendje ta ndaj vendin nga qeveria, ndaj në këto kohë dramatike e dua Rusinë shumë më tepër se kurdoherë. / Newsweek – Bota.al

DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (15)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

-69-

Nato Konfidenciale

16 korrik 1981

Shqipëria

1. Kjo notë vlerëson pozitën politike, strategjike dhe ekonomike të Shqipërisë, dhe mundësinë e implikimeve prej afrimit të mundshëm me Bashkimin Sovjetik.

Historiku: 1939-1980

2. Shqipëria, që kur u bë shtet i pavarur në vitin 1912, deri së fundmi është varur nga një fuqi e huaj për mbrojtje dhe ndihmë ekonomike. Pas luftës së fundit dukej e mundshme për një farë kohe se Shqipëria do të bëhej pjesë e Federatës Jugosllave, si rezultat i lidhjeve të ngushta të farkëtuara kur Jugosllavia e ndihmoi në krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare e cila mori kontrollin e Shqipërisë në vitin 1945. Por, kur Jugosllavia u përjashtua nga Kominterni në vitin 1948, Enver Hoxha, sekretari i parë i Partisë Komuniste Shqiptare (një post të cilin ende e mban), përfitoi nga rasti për t'u kthyer nga Bashkimi Sovjetik për ndihmë dhe për të eliminuar rivalët e tij jugosllavë nga udhëheqja. Bashkimi Sovjetik konsiderohej më shumë si aleat sepse mendohej se kishte plane territoriale për Shqipërinë.

3. Vdekja e Stalinit në vitin 1953, procesi vijues i destalinizimit dhe afrimi midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë rritën frikën e Shqipërisë se Jugosllavia mund të ushtronte përsëri ndikim mbi vendin përmes Bashkimit Sovjetik. Kur Kina filloi të kritikonte hapur Bashkimin Sovjetik në vitin 1960, ajo gjeti një aleat tek Hoxha, i cili gjithnjë e më shumë ndante pikëpamjet ideologjike dhe politike kineze. Në fillim të viteve 1960, Shqipëria ndërpreu pjesëmarrjen në Komekon dhe nuk i lejoi më përdorimin e objekteve ushtarake në vend nga sovjetikët. Prishja e plotë me Bashkimin Sovjetik ndodhi në vitin 1968, kur Shqipëria u tërhoq formalisht nga Pakti i Varshavës pas pushtimit të Çekoslovakisë. Ndërkohë, lidhjet me Kinën u forcuan. Kina e mbështeti Shqipërinë si nga pikëpamja ekonomike dhe ideologjike në këmbim të një baze në Evropë për transmetime propagandistike dhe një zë në Kombet e Bashkuara në një kohë kur Kina komuniste nuk përfaqësohej aty. Kina i dha fund

kësaj marrëdhënieje të ngushtë me Shqipërinë në vitin 1978, kur duke mos pasur më nevojë për Shqipërinë si aleate, tërhoqi ndihmën e saj ekonomike dhe ushtarake. Sidoqoftë, Kina vazhdoi të ruante marrëdhëniet diplomatike.

4. Që prej prishjes me Kinën, Shqipëria ka shmangur çdo përfshirje në blloqe dhe ka qëndruar larg angazhimeve multilaterale. E bindur për korrektësinë e interpretimit të marksizëm-leninizmit nga ana e saj, Partia Komuniste Shqiptare mbetet nga pikëpamja ideologjike armiqësore me të gjitha partitë e tjera qoftë ose jo në pushtet, dhe ka marrëdhënie vetëm me grupet marksiste-leniniste të cilat të njëjtën kredo politike e shpallin si të tyre. Bashkimi Sovjetik dhe Kina, po ashtu si Shtetet e Bashkuara, dënohen si "imperialiste", dhe Shqipëria nuk ka lidhje diplomatike apo tregtare formale me Bashkimin Sovjetik ose Shtetet e Bashkuara.

Marrëdhëniet midis Britanisë dhe Shqipërisë

5. Britania nuk ka pasur marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë që para luftës së fundit. Ka dy probleme të pazgjidhura. Qeveria shqiptare deri tani nuk është përgatitur për të rifilluar marrëdhëniet përpara dorëzimit "me interes" të arit që ka marrë përkohësisht pas luftës si dëmshpërblim për një sasi që Shqipërisë i është grabitur nga gjermanët. Ari me vlerë 26.5 milionë dollarë, më 28 janar 1981 është mbajtur nga Banka e Anglisë në emër të Komisionit Trepalësh për Kthimin e Arit Monetar, i cili përbëhet nga përfaqësues të qeverive britanike, amerikane dhe franceze. Qeveria britanike dhe ajo amerikane kanë kundërshtuar të dyja dorëzimin e arit "shqiptar" para zgjidhjes së pretendimeve të tyre respektive kundër Shqipërisë. Pretendimi britanik lind nga refuzimi i Shqipërisë për të vepruar në përputhje me çmimin e dhënë të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë prej 800,000 £ si kompensim për dëmin që i është bërë dy destroyerëve britanikë në incidentin e Kanalit të Korfuzit në vitin 1946. Përpjekjet britanike për të rifilluar marrëdhëniet para zgjidhjes së problemeve financiare deri tani nuk kanë qenë të suksesshme.

Perspektivat ekonomike

6. Shqipëria është vendi më i varfër në Evropë, por standardi i jetesës dhe kushtet shoqërore janë përmirësuar. Rritja e shpejtë e popullsisë do të thotë se vendi duhet të përpriqet për rritje të shpejtë ekonomike me qëllim krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e mëtejshëm të standardit të jetesës. Në vitin 1945 Shqipëria ishte një vend i

prapambetur bujqësor, por filloi të zhvillohej me ndihmën e ndihmës sovjetike dhe më pas kineze deri kur teknikët e fundit kinezë u tërhoqën në vitin 1978. Aktualisht, theksi kryesor në politikën e industrisë është në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, kimikatet (veçanërisht plehrat kimike) dhe inxhinieri (veçanërisht pjesët rezervë për pajisjet kapitale ekzistuese). Në bujqësi, Shqipëria ka qenë e pavarur në prodhimin e grurit që në vitin 1976 dhe madje ka prodhuar teprica të vogla për eksport.

7. Sipas shifrave shqiptare, prodhimi social u rrit me 28% gjatë periudhës së Planit Pesë-vjeçar 1976-1980, dhe në mënyrë të konsiderueshme më shpejt gjatë 2 viteve të fundit - pas tërheqjes së ndihmës kineze - sesa në vitet e mëparshme. Plani aktual Pesë-vjeçar (1981-85) synon vazhdimin e rritjes më të shpejtë, përsëri pa hua nga jashtë dhe asistencë ekonomike. Me gjithë sukseset e pretenduara për rritjen e normës së ngritjes ekonomike pa ndihmë të huaj, Shqipëria mund ta ketë tejet të vështirë që të ruajë rritjen e shpejtë ekonomike nëse vazhdon me politikën e vetëmbështetjes së paepur.

8. Shqipëria ka disa burime natyrore: naftë që mjafton për të mbuluar një të tretën e nevojave të saj dhe për të lënë një tepricë të vogël për eksport (megjithëse ka cilësi të dobët dhe vështirësi për nxjerrjen e saj), qymyr dhe një potencial të konsiderueshëm hidroelektrik. Vendi ka gjithashtu burime të rëndësishme mineralesh hekuri dhe bakri, megjithëse aktualisht prodhimi i bakrit është në një shkallë mjaft të vogël. Burimi më i rëndësishëm i Shqipërisë është kromi, për të cilin ajo është aktualisht prodhuesja e tretë më e madhja në botë dhe eksportuesja e dytë më e madhe. Por, besojmë se rezervat e vërtetuara janë ndoshta të mjaftueshme për më pak se prodhimin e 10 viteve në normat aktuale dhe përfaqësojnë vetëm rreth 1% të rezervave të përgjithshme botërore; edhe rezervat potenciale ndoshta nuk do të zgjasin më shumë se për 20 vite të tjera. Shqipëria do të jetë me fat nëse do të ruajë prodhimin e mineralit të kromit në nivelin aktual deri në fund të viteve 1980. Për pasojë, objektivi për zgjerim është i kufizuar. Do të duhet disa kohë për të zgjeruar kapacitetin e prodhimit.

Tregtia e jashtme

9. Qeveria shqiptare ka bërë përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet tregtare me 80 apo më shumë vende me të cilat ajo ka marrëdhënie diplomatike. Por, që në fillim të viteve '70, tregtia e jashtme shqiptare nuk është rritur më shumë se 600 milionë dollarë

amerikanë në vit, kur rreth dy të tretat e tregtisë bëhej me Kinën. Tregtia me vendet josovjetike Komekon është rreth 200 milionë dollarë amerikanë në vit, kryesisht me bazë shkëmbimi. Tregtia me Bashkimin Sovjetik është e papërfillshme. Tregtia me Perëndimin e zhvilluar arrin gjithashtu në rreth 200 milionë dollarë amerikanë. Shqipëria importon nga Perëndimi kryesisht hekur dhe çelik, kimikate, qymyr dhe tekstile, duke eksportuar në këmbim afërsisht tre të pestat e prodhimit të vet të kromit (një pjesë e tij është e cilësisë së dobët), nikel, tel bakri, produkte ushqimore dhe disa mallra të prodhuara. Partneri më i madh tregtar i Shqipërisë aktualisht është Jugosllavia. Kushtetuta e vendit ndalon ndërmarrjet e përbashkëta me kredi nga "monopolet dhe shtetet borgjeze dhe revizioniste e kapitaliste". Shqipëria rrallë i është drejtuar bankave perëndimore për ndihmë financiare, përveç me bazë afat-shkurtër. Kohët e fundit, Shqipëria është përpjekur të inkurajojë partnerët e saj tregtarë perëndimorë që të bëjnë tregti mbi bazën e shkëmbimit ose ndërrimit të mallrave: një gjë e tillë mund të pengojë planet për zgjerimin e këtyre lidhjeve tregtare në të ardhmen e afërt.

10. Balancimi i tregtisë shqiptare midis Lindjes dhe Perëndimit nuk është thjesht rezultat i dëshirës së udhëheqjes për të ruajtur pavarësinë politike të vendit. Pajisjet e avancuara perëndimore do të mbeten jetike për zhvillimin e industrisë shqiptare, por tregjet e Komekon janë më shumë të afta që të tërheqin mallra të prodhuara shqiptare të kualitetit të dobët. Megjithëse Shqipëria ka kapacitetin të shtojë eksportet e saj minerale dhe energjetike, ajo nuk do të jetë në gjendje të importojë të gjitha makineritë që kërkon nga Perëndimi: disa furnizime do të duhet të vijnë nga Evropa Lindore. Pozita strategjike

11. Vetë forcat shqiptare nuk kanë ndonjë domethënie të madhe. Ka katër brigada këmbësorie dhe një tankiste, rreth njëqind avionë luftarakë të mbrojtjes ajrore dhe një anije e vogël bregdetare. Të gjitha pajisjet kryesore janë të vjetra, të vjetruara dhe vuajnë nga mungesa e pjesëve rezervë dhe mirëmbajtja e tyre. Megjithatë, duke pasur parasysh pozitën gjeografike të Shqipërisë, objektet e saj ushtarake mund të kenë rëndësi strategjike nëse do të viheshin nën kontrollin e Bashkimit Sovjetik. Bashkimi Sovjetik ka përdorur më parë bazën detare të ndërtuar nga sovjetikët në gjirin e Vlorës, dhe përdorimi i kësaj pike do të ndihmonte në mënyrë të konsiderueshme në ruajtjen e nëndetësive të Flotës Veriore

Sovjetike të pozicionuara në Mesdhe, veçanërisht për arsye se aktualisht Bashkimi Sovjetik ka objekte të kufizuara tregtare në Mesdhe. Gjithashtu, kjo pikë mund të ofrojë një zonë strehimi në thellësi ujore për përdorim nga anijet mbështetëse të Skuadrilës Mesdhetare. Flota Ushtarake Detare shqiptare ka gjithashtu dy baza të vogla forcash bregdetare në Ishullin e Sazanit dhe Durrës.

12. Funksionimi i avionëve sovjetikë nga aerodromet shqiptare nën kontrollin e sovjetikëve do të rriste kërcënimin e Paktit të Varshavës nga ajri për rajonin Jugor të NATO-s, por avionët e tillë do të ishin më shumë të ekspozuar ndaj kundërpërgjigjes së NATO-s dhe do të nevojitej fluturimi mbi territorin e Jugosllavisë për të mbështetur një zotërim të tillë sovjetik. Ngushtica e Otrantos, hyrja në Adriatik, do të ishin më afër shtrirjes së avionëve sovjetikë. Aerodromet ekzistuese ndoshta do të nevojitej të rinovoheshin dhe përmirësoheshin për të përballuar operacionet sulmuese.

13. Përdorimi nga sovjetikët i objekteve shqiptare do të rriste shqetësimet e vendeve fqinje të Adriatikut, megjithëse shumë pak do të rritej kërcënimin i operacioneve tokësore dhe ajrore kundër Greqisë ose Jugosllavisë, i cili ekziston nëpër Bullgari.

Situata dhe opinioni aktual
14. Pozita gjeografike e Shqipërisë i jep asaj rëndësi më të madhe sesa do të garantonte madhësia e saj apo edhe pozicioni ndërkombëtar i saj. Bashkimi Sovjetik do të përfitonte në mënyrë të konsiderueshme nga kontrolli mbi objektet ushtarake shqiptare, veçanërisht bazën nëndetëse, dhe do ta shihte si avantazh përdorimin e Shqipërisë si bazë nga e cila të ushtronte presion ndaj Jugosllavisë apo të nxiste subversion ose destabilizim atje. Interesi kryesor i Perëndimit ishte që të mos lejonte përdorimin e objekteve shqiptare nga Bashkimi Sovjetik. Kina nuk po tregon aktualisht ndonjë interes të madh në këtë vend.

15. Shqipëria paraqet gjithashtu interes të konsiderueshëm për Jugosllavinë, e cila ka një pakicë të madhe shqiptarësh etnikë në Kosovë. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë u përmirësuan pas prishjes me Kinën; po kështu pushtimi sovjetik i Afganistanit dhe shqetësimi mbi fatin e Jugosllavisë pas vdekjes së Titos në vitin 1980 bëri që Shqipëria të rishpallte sigurimet e saj më të hershme për të ndihmuar jugosllavët në rast agresioni sovjetik. Por, brishtësia e kësaj detante dhe potenciali i Shqipërisë për të trazuar stabilitetin jugosllav nëpërmjet tërheqjes së saj natyrore për shqiptarët etnikë janë ilustruar

geografikisht nga toni i hapur nacionalist dhe irredentist i trazirave të fundit në Kosovë. Reagimi shumë i ashpër jugosllav, i cili pasqyron dyshimin e bashkëpunimit shqiptar, çoi në përkeqësimin serioz të marrëdhënieve bilaterale, dhe pezullimin e marrëveshjeve kulturore.

16. Udhëheqësit shqiptarë kanë mbetur deri sot armiqtë e Bashkimit Sovjetik dhe të shurdhër ndaj thirrjeve sovjetike për përmirësimin e marrëdhënieve. Por, besojmë se gjatë viteve të ardhshme Bashkimi Sovjetik do të vazhdojë përpjekjet e tij për të përmirësuar marrëdhëniet me Shqipërinë, ndërkohë që do të kultivojë lidhjet me çdo element prosovjetik në vend. Hoxha thuhet se është i sëmure rëndë, por nuk kemi informacion përmes të cilit të bazojmë gjykimin tonë mbi llojin e udhëheqjes që mund të dalë pas vdekjes së Hoxhës. Nevoja e ngutshme për ndihmë të huaj mund ta bëjë ndonjë udhëheqje të re më të bindur ndaj përcapjeve për afrim me sovjetikët; por dallimet e mbetura e madje ndoshta të heshtura ideologjike dhe dëshira për të shmangur paragjykimin e Shqipërisë për përmirësimin e marrëdhënieve me pjesën tjetër të botës, mund të pengojnë në praktikë zhvillimin e lidhjeve më të ngushta me Moskën.

17. Nuk mendojmë se Bashkimi Sovjetik do të ndërmerre veprime ushtarake për të fituar kontrollin mbi Shqipërinë përveç nëse ftohej nga udhëheqësit shqiptarë apo në rast të çrregullimeve të përgjithshme në Ballkan. Nëse, pas vdekjes së Hoxhës në Tiranë do të vinte në pushtet një udhëheqje prosovjetike, pa dyshim që Bashkimi Sovjetik do të kërkonte të ketë objekte ushtarake në vend, dhe me qëllim sigurimin e tyre për një periudhë të gjatë kohore, ndoshta do të dëshironte ta tërhiqte Shqipërinë sërish në Komekon, në mos në Paktin e Varshavës. Shqipëria ndoshta do të kërkonte që të arrinte një quid pro quo (kompensim) të rëndësishëm për objektet ushtarake. Bashkimi Sovjetik mbase do të ishte përgatitur për të paguar një çmim mjaft të lartë për një marrëdhënie të tillë, megjithëse një barrë shtesë financiare nuk do të ishte mirëpritur për anëtarët e tjerë të Komekon. Sidoqoftë, një kosto më të madhe do të kishte frenimi i pashmangshëm i përpjekjeve sovjetike për të rifituar ndikimin në Jugosllavi, të cilën ata e shohin qartazi si një çmim më të mirë.

-70-

JCR Gray Esq

Ambasada britanike
Beograd
EESD
FCO
21 korrik 1981

Kosova: foto të demonstratave

Inderuar, Zotëri

1. Shtypi i ilustruar i Beogradit ka

filluar më së fundi të publikojë foto të demonstratave në Kosovë. Bashkangjitur po ju dërgoj disa prej tyre me interes për ju.

I Juaji,
Charles Crawford
Oficer Informacioni

Foto A:

"Nacionalistët shqiptarë hodhën gurë ndaj atyre që nuk bashkohen me ta".

"Detyra e tyre është të trazojnë popullin: me një megafon përballë ndërtesës së LKK-së".

"Nacionalistët dhe irredentistët më fanatikë mbanin shkopin".

Foto B:

"Prishtinë: fillimisht demonstruesit dolën me parulla "shoqërore", por më pas fytyra e armikut u zbulua".

Foto C:

"Foto nga dita me trazira e pranverës: Milicët kanë ndaluar një grup demonstruesish dhe po i bindin që të shpërndahen dhe të mos mashtrohen nga armiku".

-71-

Konfidenciale

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
EESD
FCO
21 korrik 1981

Kosova: përgjegjësia politike

Inderuar Alan,
Përmbledhje

1. Drejtimi i trysnisë së krijuar gjatë javëve të fundit ka rezultuar në dorëheqjen e Xhavit Nimanit, kryetar i Kryesisë së Kosovës. Deklarata e dorëheqjes së tij nuk shprehte aspak keqardhje. Priten dorëheqje të tjera, nëse (disi të parakohshme) spekulimet e shtypit janë njëfarë treguesi.

Detaje

2. Botimi më i fundit i gazetës "NIN" përmbante një kryeartikull të titulluar "Dorëheqjet e pritura". Në fjalitë e para thuhet: "Fundit i kësaj jave ka shënuar në Kosovë dorëheqje të reja të udhëheqësve të lartë të Krahinës... Tashmë kjo pengesë është hequr. Dorëheqjet në një farë mënyre janë ofruar, apo dhënë nën presionin e opinionit publik, megjithëse disi vonë". Artikulli vazhdonte më tej me një ton morali të lartë mbi papranueshmërinë e spastrimeve që do të preknin vetëm ata të cilët ishin më afër limiteve të situatës ndërsa më të rëndësishmit do të mbeteshin të pacënuar; gjithashtu, artikulli komentonte nevojën për të trajtuar çështjen e rinovimit të gazetës "Obnova". Kjo tingëllonte e shkëlqyeshme dhe e guximshme në stilin e ri të "NIN", por kishte diçka qartazi të dyshimtë: asnjë emër nuk përmendej. Kërkuam shtypin e asaj dite, 17 korrik, dhe nuk gjetëm asnjë fjalë për dorëheqjet. Në fund i telefonova autorit të artikullit dhe e pyeta nëse dinte ndonjë gjë që nuk e dinte askush tjetër. Ai e pranoi se dinte, por u shpreh se do të vihej në pozitë të vështirë po të thoshte më shumë, përveç se të konfirmonte se, siç e kishim dëgjuar unë dhe



Charles Crawford nga një gazetar dy ditë më parë, bëhej fjalë për emrin e Nimanit. Atë mbrëmje, në lajmet e TV u njoftua dorëheqja e Nimanit, por nuk u përmend asnjë emër tjetër.

3. Në shpjegimin e gjatë për veprimin e tij, Nimanit e identifikoi veten me denoncimin zyrtar të kundërrevolucionit, lavdëroi arritjet e Kosovës dhe shprehu optimizmin e tij për të ardhmen. Megjithatë, ai e pranoi se armiku kishte shfrytëzuar disa "mosmarrëveshje" dhe kishte molepsur mendjet e të rinjve me ndjenja të tilla si nacionalizmi, për të cilat mbanin përgjegjësi jo vetëm Lidhja e Komunistëve, por të gjithë "faktorët e tjerë subjektivë", d.m.th. Lidhja Socialiste, Bashkimi i Rinisë etj. Ai e pranoi se përgjegjësi të veçantë kishin organet politike dhe ato shtetërore të Krahinës. Ai bëri thirrje për marrjen e masave më vendimtare për të eliminuar gabimet dhe dobësitë e LK-së, LSPP-së dhe organeve qeveritare. Më tej, ai ia vuri gjithë fajin Shqipërisë për abuzimin me "vullnetin tonë të mirë, gatishmërinë dhe sinqeritetin" në zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, megjithëse pati mirësinë të pranonte se "ne nuk ishim vigjilentë sa duhet". Duke i kthyer përsëri çështjes së fundmi, ai tha, "duke dashur të jap kontributin tim maksimal në luftën kundër armikut dhe në stabilizimin e situatës në Kosovë nga njëra anë dhe nga ana tjetër për t'i prerë rrugën spekulimeve dhe dezinformimit për mua nga armiku, deri më sot kam vendosur që të mos jap dorëheqjen, për shkak të situatës së vazhdueshme, megjithëse e ndjeja përgjegjësinë time politike personale si kryetar i Kryesisë së Kosovës. Megjithatë, tashmë që përpjekjet ndaj kundërrevolucionit janë thyer dhe situata i është kthyer normalitetit, kam arritur në përfundimin se është koha që të jap dorëheqjen". Ai vazhdoi më tej duke u zotuar se do të ofronte mbështetjen e tij në luftën kundër armikut.

4. Ashtu si në rastin e dorëheqjeve të mëparshme, Nimanit nuk shprehu asnjë fjalë keqardhjeje dhe është e qartë se ai nuk e konsideronte veten fajtor për asgjë që mund ta bënte të ndjehej i turpëruar. Gabimet e panumërta dhe gjerësisht të njohura që kishte

bërë administrata e tij, u kaluan në heshtje.

5. Do të jetë me interes të shikojmë se çfarë do të bëhet në Nimanin tani, veçanërisht nëse do të fillojë ndonjë procedurë ligjore ndaj tij. Bakalli, ish-kryetari i LK-së së Kosovës është falur me një paralajmërim nga Kryesia e LK-së, se çështja e anëtarësimit të tij të ardhshëm në Komitetin Krahinor të Kosovës do të shqyrtohet në dritën e vetë sjelljes së tij. Ndërkohë, ishte njoftuar më 14 korrik se ai nuk ishte më anëtar i Kryesisë së LK-së. Kjo vonesë e gjatë ndodhi ndoshta për arsye të kritikës ndaj tij për faktin që ai vazhdonte të paraqitej në mbledhje sikur nuk kishte ndodhur asgjë.

6. Nuk kam mundur t'i shkoj deri në fund historisë së gazetës "NIN" për dorëheqjet. Mund të jetë që në përpjekjen e tyre për të qenë aktualë (gjë që është gjithmonë e vështirë për një gazetë të përjavshme) ata jo vetëm që u nxituan, por gjithashtu pretenduan tepër nga dorëheqja e Nimanit, ose, ata kanë të drejtë dhe akoma më tej, gjë që ende nuk është shpallur, do të vijojnë dorëheqjet. Natyrisht kjo është ajo ç'ka pritet nga shumë njerëz këtu. Më kanë thënë se gazetari në fjalë është në telashe dhe nuk flet.

I Juaji,

Jemy T. J. Clark

Për dijeni: P. Rennie Esq

Departamenti i Kërkimit, FCO

-72-

Konfidenciale

Fm Beograd ZLGR4067 03JUL8
ENU 015/3
TO EXTOTT GEA
23 korrik 1981

Situata në Kosovë

1. Për momentin situata në vetë krahinën e trazuar të Jugosllavisë, Kosovë, duket se është stabilizuar dhe të paktën nën kontroll të përkohshëm. Debatimi mbi shkaqet dhe efektet e manifestimit nacionalist tregon shenja të vogla rënieje. Në aspektin e brendshëm, fokusi i vëmendjes publike është zhvendosur në çështjen e përgjegjësisë së shtetit në nivel lokal, krahinor dhe federal si dhe zyrtarët partiakë. Ndërkohë që disa

zyrtarë partiakë, duke përfshirë ish udhëheqësin Bakalli kanë dhënë dorëheqjen nën presion, shumë prej atyre të cilët qartazi mbanin përgjegjësi aktive ose pasive pasi kishin lejuar që situata të përkeqësohej siç edhe ndodhi, janë ende në detyrë.

2. Raportimi mbi ngjarjet në Kosovë është bërë kohët e fundit më intensiv dhe i ka dhënë shkas kërkesave, veçanërisht nga gazeta "të frymëzuara" për një politikë më aktive diferencimi midis atyre që shihen si kosovarë të mirë dhe të këqij që në të vërtetë bëjnë thirrje për spastrimin e atyre që shoqërohen me grupe nacionaliste dhe irredentiste shqiptare apo ata që lejuan lulëzimin e tyre. Në masë të madhe ky sinqeritet i informacioneve për Kosovën ka pasur dobi për sa i përket ekspozimit të sjelljes së papërgjegjshme, oportunitizmit dhe paaftësisë nga ana e disa udhëheqësve kosovarë. Nga ana tjetër, ndërkohë që deri vonë pjesa më e madhe e kritikës publike drejtohej ndaj qeverisë në nivel federal dhe krahinor për kufizimin e raportimit mbi ngjarjet, sot media, veçanërisht revistat e ilustruara, po kritikohen për sensacionalizmin dhe ekzagjerimin e anës negative të çështjeve. Ende nevojitet vendosja e një ekuilibri në këtë drejtim. Gjithashtu, me mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis udhëheqjes së Beogradit dhe asaj të Kosovës në lidhje me ritmin e diferencimit, një gjë e tillë kërkon kohë.

3. Vizita në Kosovë javën e kaluar nga gazetarë, midis të tjerëve, e një korrespondenti lokal të "Reuters" me të cilin biseduam pas kthimit të tij, priret të konfirmojë se duke lënë mënjanë ekzagjerimet rastësore, situata në këtë zonë është shumë e njëjtë me atë që po raportohet në medien jugosllave. Dëmet janë ndrequr dhe me ndihmën e një numri të madh të forcave të sigurisë, është rivendosur rendi. Kinematë dhe stadiumet e sportit kanë mbetur të mbyllura dhe tubimet publike mbikëqyren nga afër nga policia e mirarmatosur dhe e pajisur kundër trazirave. Diplomateve u kërkohet ende të marrin leje për të vizituar krahinën, por në kontrast me gazetarët (vizitat e të cilëve sidoqoftë janë "të organizuara") kjo leje jepet vetëm në raste të tralla. Sipas gazetarëve

të "Reuters", të cilët folën me kosovarë të nacionaliteteve të ndryshme, shumica në këtë krahinë duket se janë dakord që qetësia aktuale do të vazhdojë gjatë muajve të verës dhe zyrtarët në krahinë presin që së shpejti të hiqen kufizimet e mbetura. Megjithatë, kosovarët me origjinë shqiptare i përmbahen me vendosmëri qëllimit të statusit të Republikës më vete për Kosovën. Megjithëse kanë provuar përdorimin e dhunës për këtë qëllim, e pranojnë gjerësisht se kjo rrugë është antiproduktive.

4. Në frontin ndërkombëtar, shkëmbimet sarkastike midis Beogradit dhe Tiranës duket se, po humbasin disi nga entuziazmi i mëparshëm, në mos po çojnë në zemërim. Ish-ministri i Jashtëm jugosllav i cili kryeson Këshillin Federal për marrëdhëniet ndërkombëtare, theksoi javën e kaluar në një konferencë për shtyp se ndërkohë që qeveria shqiptare kërkon të ndryshojë kushtetutën e Jugosllavisë dhe qëndron pas terrorizmit në Kosovë "Jugosllavia nuk ka asnjë interes që të prishë bashkëpunimin e saj me Shqipërinë. Përkundrazi, ajo e dëshiron këtë bashkëpunim, por mbi baza reciproke". Tirana, duke kundërshtuar akuzat se po nxit kauzën e "Shqipërisë së Madhe" në kurriz të Jugosllavisë dhe Greqisë, është përgjigjur me akuzat e saj se pas kësaj "shpikjeje të neveritshme" dhe "urrejtes së egër ndaj Shqipërisë dhe një vargu shpifjesh aktuale që Jugosllavia po përpiqet të përhapë si mbulim për vetë dështimet e saj dhe shtypjen në Kosovë" fshihen "Serbët e Mëdhenj" të Beogradit dhe policia sekrete jugosllave satanike e ndihmuar nga aleatët klandestinë sovjetikë. Kundërpërgjigja më e fundit e Shqipërisë duket se është drejtuar ndaj ruajtjes së marrëdhënive të mira me Greqinë po aq sa ndaj provokimit të një përgjigjeje tjetër nga Beogradi. Sidoqoftë presim që loja të vazhdojë për një kohë më të gjatë.

CCC/088 060616Z ZLGR4067

-73- Airgram

Drejtuar: Departamenti të Shtetit
Për informacion: Ambasadës në Paris

Nga: Ambasada në Beograd
Për ndjekje: ECON, EGEN, YO
23 korrik 1981

Tema: Aspektet ekonomike të Kosovës

Kanë kaluar katër muaj që prej shpërthimit të demonstratave në disa qytete të Kosovës këtë pranverë. Të quajtura armiqësore dhe kundërrevolucionare, demonstratat e dhjetëra mijërave studentëve dhe punëtorëve janë përshkruar gjithashtu si trazira nacionaliste shqiptare. Një vëzhgues i jashtëm mund të arrinte në konkluzionin se do të mjaftonte vetëm keq-menaxhimi që të shkaktonte trazirat ose në fund të

fundit që çështjet ekonomike të ndërlikonin një situatë të brendshme tashmë të ndezur socio-politike. Edukimi i rinisë së krahinës është drejtuar keq duke i bërë të rinjtë të pakontrollueshëm; kapitali është keqorientuar në një industri të rëndë që kërkon shumë kapital kur krahina kishte nevojë për mijëra punë të nivelit fillestar; gjithashtu një pjesë e vogël e vegjëlisë është ngritur në një nivel më të mirë ekonomik për të shërbyer si shembull joshës. Qeveria jugosllave krijoi menjëherë teori konspirative të bazuara në ndërhyrjen nga jashtë. Qeveria jugosllave ia ngarkoi përgjegjësinë për demonstratat provokimit të jashtëm dhe theksoi se si programet për zhvillimin e brendshëm ekonomik e kanë rritur standardin e jetesës në mënyrë të konsiderueshme që prej Luftës së Dytë Botërore. Sidoqoftë, sot janë më të zakonshme raportet për keqorientimin e qëllimeve të zhvillimit dhe shpenzimit pa hesap të fondeve në projekte sociale që kërkojnë kapital më shumë se në objektet prodhuese. Mbi Republikat jugosllave po ushtrohet më shumë presion federal për të investuar në Kosovë bazuar në premtimet e tyre të mëparshme dhe në përputhje me planet kombëtare. Modeli i zhvillimit të brendshëm në Kosovë, e tërë përpjekja për zhvillim, është orientuar aq keq (pjesa më e madhe nga zyrtarët lokalë) sa që ka dekurajuar firmat në republikat e tjera që të hyjnë në ndërmarrje të përbashkëta.

Kosova ka karakteristika të ngjashme me ato vende që e kanë bërë zhvillimin dhe stabilitetin politik aq të vështirë tjetërkund në Botën e Tretë: dallime të theksuara rajonale, etnike dhe ekonomike të shoqëruara me armiqësi historike; norma e rritjes së popullsisë që ia kalon aftësisë së rajonit për të krijuar vende pune; produktiviteti i ulët i punës, dhe përdorimi i joefikas i kapitalit, të gjitha këto kombinohen me një krizë tipike të pritsmërive në rritje. Ndërkohë që është e pasur me minerale, Kosovës i mungojnë fabrikat dhe aftësitë teknike për shfrytëzimin e tyre përtej përpunimit fillestar dhe pjesa më e madhe e vlerës i shtohet republikave të tjera - të cilat më pas marrin fitime të rëndësishme. Sidoqoftë, Kosova mbetet pjesë përbërëse e një vendi të angazhuar për ta ngritur atë në nivelin e mesatare kombëtare në çdo fushë. Interesat e Jugosllavisë në zhvillimin e Kosovës janë politike dhe ekonomike. Politikisht, zhvillimi i shpejtë është parë si afirmim i parimeve bazë të vendit, si një politikë e barazisë për të gjitha grupet etnike në Jugosllavi dhe, në nivel ndërkombëtar Jugosllavia duhet të tregojë vullnetin për të bërë për pjesën e vet të pazhvilluar po aq sa do të dëshironte që Perëndimi të bënte për Botën e Tretë në përgjithësi. Për më tepër, zhvillimi i Kosovës do të shërbente për zbutjen e tensioneve në një zonë problemesh të irredentizmit dhe minoriteteve



rivale etnike që janë probleme tradicionale politike të Ballkanit. Mbi të gjitha, Beogradi kërkon që të mbrojtë integritetin e vet territorial dhe unitetin kombëtar kundër irredentizmit shqiptar, të cilin e shikon gjithashtu si një instrument potencial të fuqisë sovjetike. Për shkak të rëndësisë kulturore, historike dhe emocionale të krahinës, problemet e thjeshta në Kosovë bëhen tejet të ndërlikuara. Kosova është zemra e mbretërisë së vjetër të Serbisë, vendi ku Serbia humbi një betejë historike me turqit e cila rezultoi në 500 vjet sundim të huaj. Nga pikëpamja ekonomike, krahina përmban 50% të qymyrit të vendit dhe 60% të plumbit dhe zinkut dhe sasi të konsiderueshme të mineraleve të tjera. Po ashtu, potenciali bujqësor nuk është i parëndësishëm. Sidoqoftë, problemi kombëtar për zhvillimin e Kosovës nuk e mbron nga gabimet e zakonshme zhvillimore dhe as nuk ndalon tendencat e vazhdueshme negative.

Rritja e popullsisë së krahinës, kryesisht rritja shqiptare etnike, duke përjashtuar të gjithë faktorët e tjerë për një moment, është duke prishur në vetvete shumicën e përpjekjeve ambicioze të zhvillimit të shpenzuara deri tani. Norma e rritjes, 2.5 - 2.7% në vit, është karakteristike e disa prej vendeve të Afrikës dhe Amerikës Latine dhe është në kontrast krejt të kundërt me mesataren vendase prej 86% në vit.

Popullsia prej 1.58 milion, me 77% shqiptarë, përfaqëson 7% të popullsisë së përgjithshme të Jugosllavisë. Deri në vitin 2000 vlerësimet zyrtare tregojnë se Kosova do të përfaqësojë 10% të popullsisë së Jugosllavisë. Para Luftës së Dytë Botërore popullsia ishte pothuajse tërësisht fshatare dhe kishte një strukturë sociale të bazuar në besnikërinë e fortë me familjen dhe udhëheqjen fetare. Kjo tablo ka ndryshuar ngadalë që prej luftës, me gjithë rritjen e vëmendjes ndaj urbanizimit, industrializimit dhe arsimimit. Edhe sot Kosova përfaqëson 4% të territorit kombëtar e megjithatë ka vetëm 2.9% të rrugëve moderne të tij. Kjo pjesë prej 7% e popullsisë jugosllave ka vetëm 2.4% të automobilave, 2.5% të rrugëve dhe televizorëve, dhe vetëm 1.8% të

traktorëve të kësaj popullsie.

Punësimi

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, në qytete u krijuan vende pune dhe njerëzit vërshuan drejt këtyre mundësive. Popullsia bujqësore, që përbënte 65% në vitin 1961, ka rënë në 36% në vitin 1980. Rezultatet e shpërnguljes janë, numri i madh i papunësisë, zonat urbane të mbingarkuara dhe rritja e varësisë nga punësimi në prodhim. Ndërsa, Kosova ka vetëm 3% të punëtorëve të Jugosllavisë, ajo ka 8% të papunëve të saj. Ka 5.7 milionë veta të punësuar në "sektorin social" të Jugosllavisë ose 26% e popullsisë së vendit. Në krahasim me këtë, popullsia punonjëse e Kosovës përfaqëson 13% të banorëve të saj. Meqenëse pjesa më e madhe e vendeve të punës të krahinës janë relativisht të reja, do të ketë një normë të ulët qarkullimi. Punësimi maksimal në vitin 1985 do të përbëhet prej 260,000 vendesh në sektorin e socializuar. Në këtë shifër është përfshirë burokracia e fryrë e vendit. Në nivel kombëtar, 17% e popullsisë është e punësuar në aktivitete jo-ekonomike, organizatat qeveritare, kulturore dhe sociale; 26% të tillë janë të punësuar në Kosovë (madje Serbia, e cila rregullon si burokracinë federale dhe atë republikane, ka vetëm 18%).

Mbi një vlerësim bazuar për frymë, krahina ka arritur 676 dollarë të prodhimit social për frymë (më pak se gjysma e Maqedonisë fqinje (1,616 dollar) dhe Mali i Zi (1,534 dollar) ku të dyja rastet filluan nga pozita të ngjashme në vitet 1950). (Duhet të përmendet se ndihma e zhvillimit rajonal të këtyre dy republikave filloi në vitet 1950, ndërsa Kosova merrte pak deri në vitet 1960). Numri prej 200,000 personash me fat të punësuar në sektorin e socializuar, kanë një situatë përmirësimi të shpejtë. Shtypi raporton se fitimet e tyre (të papërcaktuara) arrinin deri në 47% në tremujorin e parë të vitit 1981. Shifrat aktuale në dispozicion tregojnë se paga që çojnë në shtëpi në vitin 1981 ka arritur një mesatare mujore prej 230 dollarësh, që është mbi mesataren e Kosovës prej 212 dollarësh për vitin 1980. Mbi bazën e këtyre të dhënave pjesa tjetër e popullsisë ka një mesatare vjetore të të

ardhurave për frymë prej vetëm 240 dollarësh. Vetëm 7 nga 22 bashkitë e Kosovës prodhojnë 75% të të ardhurave bruto të Krahinës. Të ardhurat bruto në kapital për Prishtinën, janë 3 herë më shumë se mesatarja e krahinës në tërësi dhe në të njëjtin nivel me mesataren kombëtare.

Të dhënat e mësipërme nuk përfshijnë fitimet nga një punë e dytë; megjithatë në bisedat me të rinjtë studentë dhe punëtorët, njeriu del me idenë se mund të bëhen para përmes iniciativës private. Kjo ndoshta nënkupton punën si punëtor ndërtimi në tregun e lulëzuar të banesave private në Prishtinë, ose si mekanik në garazhin e vet (ndërkohë që pret për një punë zyrtare), ose në një larmi profesione të tjera shërbimi.

Në rastin më të mirë, punët "e ligjshme" punësojnë një në tetë persona të popullsisë krahasuar me një në katër të tillë në nivel kombëtar. Ndërkohë që ka një përparim të jashtëzakonshëm krahasuar me periudhat e mëparshme, kjo shifër mbetet totalisht e pamjaftueshme kur krahasohet me kërkesat në rritje. Ajo përfaqëson afërsisht një punë në sektorin e socializuar për familje (madhësia mesatare e familjes në Kosovë është 6.89 anëtarë krahasuar me 3.6 për të gjithë Jugosllavinë).

Nga mesi i korrikut, ishin 72,000 veta, shumica të rinj, të regjistruar pranë zyrave të punësimit si persona që kërkojnë punë. Është një total prej 190,000 të rinjsh midis moshës 14 dhe 20 vjeç të cilët së shpejti do të hyjnë në tregun e punës. Në Universitetin e Prishtinës në kryeqytetin e Krahinës, mbi 57,000 studentë do të diplomohen gjatë katër viteve të ardhshme. Në të vërtetë, gjysma e popullsisë është duke ndjekur një nivel të caktuar shkollimi. Ndërkohë që të rinjtë mund të caktohen në shkollë apo në ushtri, eventualisht ata kanë nevojë për punë.

Arsimi

Programet arsimore janë sinkronizuar dobët me mundësitë reale ekonomike të Krahinës - ose edhe me Jugosllavinë si e tërë. Theksi kryesor i arsimit në Kosovë kanë qenë profesionet zyrtare joteknike dhe artet liberale

shqiptare. Pjesa më e madhe e studentëve, meqenëse serbo-kroatishja nuk kërkohet më, nuk zotërojnë domosdoshmërisht dy gjuhë për të fituar një punë të nivelit profesional jashtë Kosovës.

Universiteti i Prishtinës ka qenë më parë degë e Universitetit të Beogradit. Si një entitet i pavarur, Universiteti i Prishtinës është vetëm 10-vjeçar dhe është planifikuar të sistemojë 1/3 e ngarkesës aktuale të tij prej 47,000 studentësh. Një profesor mund marrë në provim 1,000 deri në 2,000 studentë në çdo periudhë provimi (provimet jepen me gojë dhe me shkrim). Natyrisht, me rritjen e numrit të studentëve çdo provim ka probleme. Disa nga problemet e tjera të Universitetit u paraqitën në një raport të kohëve të fundit në shtyp për një mbledhje paraprake, të mbajtur në Universitetin e Prishtinës për një mbledhje të ardhshme të Komitetit Qendror të Partisë:

Disa probleme janë aktuale ... duke përfshirë një staf mësimdhënës të trajnuar jo siç duhet, tekste shkollorë të pamjaftueshme, mungesë bashkëveprimi ndërmjet arsimit të lartë dhe nevojave të ekonomisë që rezultoi në vështirësitë për të siguruar vende pune për të diplomuarit. Gjithashtu u theksua se ... rinia hyri nën ndikimin e ideve nacionaliste.

Vendimi me qëllimin e mirë për të ngritur një universitet të plotë në Prishtinë nuk solli atë që krahina kishte nevojë. Pothuajse në mënyrë të pashmangshme Universiteti u konstatua se i kushtonte shumë pak kohë aftësive vendimtare të nevojshme për ekonominë e krahinës. Sot, me një numër më të madh studentësh të letërsisë sesa Franca (sipas një zyrtari) studentët nuk kanë ndonjë aftësi të tregueshme. Duke pasur parasysh tregun e punës, ata po përballen me mosgjetjen e punës, me punë nën nivelin e diplomimit të tyre apo me emigrimin. Që prej demonstratave janë bërë përpjekje për të rishikuar programet arsimore të krahinës. Në përgjithësi, Universiteti i Prishtinës synon të pranojë 19% më pak studentë kur të rihapet krahasuar me vitin 1980. Regjistrimi në kurset e arteve liberale do të bjerë në mënyrë drastike dhe regjistrimet në fakultetet teknike do të rriten. Edhe në këtë mënyrë, studentët nuk kanë shpresë për punësim të përshtatshëm.

Industria Ndërkohë që eksporton lëndë të parë me vlerë mbi 200 milionë dollarë çdo vit, Kosova sapo është duke filluar që t'i shtojë vlerën produkteve të saj të papërpunuara. Qymyri me cilësi të dobët i krahinës, po shndërrohet në energji elektrike (dhe programi për të dyfishuar kapacitetin, Kosova B, duket se po shkon drejt përfundimit në vitin 1982). Propozimi për t'i shitur energji elektrike një konsorciumi të Evropës Perëndimore duket se është lënë në harresë pasi asgjë nuk është njoftuar që kur një drejtor i

lartë shkoi në Evropë për bisedime një vit më parë. Kjo mund të ketë sjellë një lulëzim të madh ekonomik për krahinën. Kompleksi i Trepçës (punëdhënësi më i madh i krahinës) që ka lidhje të ngushta funksionale dhe licencimi me korporatën "Globe Union Battery of Milwaukee" është në krye të nxitjes për të rritur vlerën. Duke bërë punime minerale të plumbit, zinkut, argjendit etj., Trepça prodhon gjithashtu produkte të gatshme të tilla si bateritë me acid plumbi që shiten në të gjithë Evropën. Ajo po kërkon aktivisht të shpërndajë dhe të kërkojë partnerë për të rritur vlerën e argjendit të nxjerrë. Në dallim nga kjo, pjesa më e madhe e verës së prodhuar në Kosovë përpunohet në Slloveni. Partneri investitor sloven merr monedhe të fortë nga eksportet në Evropën Perëndimore dhe e paguan Kosovën në dinarë të dobët.

Sipas planit fillestar pesë-vjeçar për vitet 1981-1985, përpjekjet për zhvillimin e Kosovës duhej të vazhdonin në një shkallë më të madhe se asnjëherë. Pritej që të zgjeroheshin arsimit, kultura, shëndeti publik, ndërtimi i shtëpive si dhe projektet industriale dhe të tjera zhvillimore. Përpjekjet e mëparshme të zhvillimit nuk mund të pengonin zhvillimin në mënyrë më të ngadaltë të Kosovës se pjesa tjetër e Jugosllavisë. Është e dyshimtë nëse intensifikimi i një përpjekjeje të tillë do të mbulonte hendekun e gjerë midis Kosovës dhe pjesës tjetër të Jugosllavisë. Është shtrirë tashmë aftësia e krahinës për të thithur fonde nën strategjinë aktuale të zhvillimit. Ndërkohë që nuk ka dyshim se të gjitha fondet e planifikuara për zhvillimin e Kosovës gjatë periudhës 1981-1985 do të shpenzohen, ka shumë pak gjasa që të përmbushen objektivat e përgjithshme të zhvillimit. Në fakt, ka pasur një raport të anasjelltë midis prioritetit ekonomik dhe investimeve të përfunduara. Aktualisht janë investuar vetëm 70% e fondeve të planifikuara për bujqësinë; janë përdorur vetëm 66% e parave të disponueshme për transportin, industrinë e ndërtimit, tregtinë, hotelet dhe restorantet, turizmin dhe pyjet, ndërkohë që ka përfunduar 92% e programit të planifikuar joekonomik. Këtu përfshihen ndërtesat e zyrave qeveritare, qendrat sportive, ambientet universitare, teatrot etj.

Një nga rezultatet e trazirave të vitit 1981 ishte rishqyrtimi i koncepteve që gjendeshin pas planit të periudhës 1981-1985. "Projekti final" tashmë i përgatitur duhet të ndryshojë në mënyrë thelbësore. Një pjesë e rëndësishme, 50% e fondeve të lira për investim do të investohen në ndërmarrjet e përbashkëta që kërkojnë fuqi punëtore pranë firmave nga republika të tjera (30% nevojitet për projektet në ndërtim dhe 20% janë përcaktuar për të shlyer financimin e mëparshëm). Ka pasur raporte që tregojnë se prodhimi është rritur dhe ka reduktuar mosvajtjen në



punë gjatë trazirave dhe pas tyre. Ekzistojnë ndoshta disa operacione të suksesshme ku prodhimi është rritur këtë vit. Në pjesën më të madhe këto raporte janë ekzagjeruar për përdorim të brendshëm, ose tregojnë se njerëzit shkuan në punë që të mos shihen si pjesëmarrës në këtë krizë. Edhe para trazirave, statistikave të tremujorit të parë treguan humbje të përgjithshme të jashtëzakonshme ekonomike në Kosovë. Norma e rritjes industriale ishte 24% nën mesataren kombëtare në vend të treguesit prej 6% që ishte programuar mbi këtë mesatare. Eksportet ranë me 4% në përgjithësi krahasuar me të njëjtën periudhë vitin e kaluar, por pothuajse me 50% krahasuar me vendet me monedhë të fortë. Si rezultat, krahina sot nuk ka monedhë të këmbimit valutor për të blerë mallrat e nevojshme për prodhim të mëtejshëm. Nuk është përmbushur norma e rritjes së synuar prej 5½%, e cila është për të siguruar vendet e punës përmendur më lart; raportet fillestare për periudhën janar-qershor tregojnë për një normë rritjeje prej 4.4%. Trazirat nuk kanë sjellë dobi në përmirësimin e situatës. Shtypi raporton se humbjet financiare të shkaktuara nga vëllimi i ulët i shitjeve nga industria e Kosovës në përgjithësi kanë tejkaluar humbjet për të gjithë vitin 1980. Humbjet industriale të tremujorit të parë kanë arritur në 42.4 milionë dollarë kundrejt shifrës 57 milionë dollarë për të gjithë vitin 1980. Të gjitha këto humbje nevojitet të zëvendësohen, kështu që financimi pasues e rrit barrën e borxhit dhe i pengon firmat që ndonjëherë të rimarrin përfitimet e tyre pa shuar borxhet nga institucionet huadhënëse federative.


Mbi 920 projekte janë në zhvillim e sipër në Kosovë. Jugosllavia ka investuar mbi 2 miliardë dollarë në këtë krahinë që prej vitit 1976, 56% nga fondi federal për zhvillim, dhe do të shpenzojë një shumë tjetër prej 3-5 miliardë dollarësh deri në vitin 1986. Pjesa më e madhe e kësaj shume do të nxirret nga fondi federal. Ndihma ndërkombëtare (kryesisht Banka Botërore) mund të rrisë këtë shifër me një shtesë prej 2 miliardë dollarësh. Fatkeqësisht,

pothuajse çdo projekt në Kosovë ofron deri më sot një normë të ulët fitimi. Projektet kanë filluar vitin e kaluar dhe ende të papërfunduara vlerësohen në masën 2 miliardë dollarë. Pjesa më e madhe e investimeve për periudhën 1975-1980 i kaluan disa projekteve të mëdha me kosto të lartë të cilat i kanë shkelur të gjitha afatet e parashikuara ose ndryshe, janë të vonuara. Pjesa më e madhe e fondeve për planin e mëparshëm kaloi në zhvillimin e qymyrit, plumbit, zinkut, nikelit, sistemin në shkallë të gjerë të ujitjes në sektorin bujqësor plus industrinë bazë kimike dhe të përpunimit të metalit. Këto janë industri që kërkojnë shuma të mëdha kapitali, kryesisht të ngritura me kosto të lartë, potencial të ulët punësimi dhe gjithashtu potenciale të ulëta fitimi. Shpesh, as stafet menaxheriale dhe as ato teknike nuk janë të mjaftueshme për detyrat e kërkuara. Rezultatet janë produktiviteti i ulët dhe koston e larta në çdo moment. Raportet e tremujorit të parë tregojnë se 210 organizata pune të Kosovës (të cilat kanë punësuar 42,000 persona) ishin në borxhe. Një gazetë së fundmi ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur "arsyet subjektive" në vijim për zhvillimin e ngadaltë të krahinës: shfrytëzimi i pamjaftueshëm i kapaciteteve ekzistuese, dështimet e shpeshta në kapacitete, organizimi i dobët i punës dhe produktiviteti i ulët i punës si dhe gabimet në politikën e investimit. Ndërkohë që shumë nga këto industri bazohen në burime të pasura minerale lokale, një numër i tyre janë ekonomikisht të pajustificueshme, që nuk bazohen as në aftësitë lokale dhe as në burimet lokale.

Sektori i socializuar i ekonomisë së Kosovës përfaqëson 2.7% të ekonomisë së socializuar të Jugosllavisë, por pjesa tjetër e Jugosllavisë vazhdon të furnizojë Kosovën me pothuaj 4% të kapitalit të investimit të vendit. Kjo situatë do të vazhdojë për arsye sociale-politike, megjithëse norma bruto e fitimit të Kosovës në investimin e sektorit të vet të socializuar përbën normën e dytë më të ulët të vendit në masën 74%. Mali i Zi që ka

normën 58% është më keq, por kjo pasqyron vonesat e rindërtimit nga tërmeti dhe një nivel ende të konsiderueshëm dëmsh. Mesatarja e vendit është 92.6%. Përveç humbjeve të drejtpërdrejta për shkak të trazirave prej së paku 2 milionë dollarësh (kompania më e madhe e sigurimeve të krahinës ka kryer 250,000 dollarë të kërkesave), plus kostot e shërbimeve shtesë publike, republika po humbet prej muajsh të ardhurat nga turizmi meqenëse vizitorët e huaj nuk lejohen që të kalojnë aty apo që të vizitojnë vendin. Të paktën një firmë e huaj është vonuar në vajtjen e inxhinierëve të vet aty për të instaluar disa pajisje thelbësore në një fabrikë të madhe. Ministria e Jashtme ka nxjerrë një kërkesë që të gjitha udhëtimet e të huajve në Krahinë duhet të miratohen nga Sekretariati Federal i Punëve të Jashtme (SFPJ), kërkesë e cila është nxjerrë në fillim të trazirave dhe nuk është hequr ende. Ndërprerjet e punëve përbëjnë një tjetër faktor të kushtueshëm që duhet llogaritur kur nxirren të dhënat. Aktualisht të dhënat janë kontradiktore dhe bëjnë që llogaritjet e kostove të përgjithshme të tingëllojnë të pamundura. Është e panevojshme të thuhet që humbjet do të jenë të rënda. Sipas të gjitha gjasave, nuk mund të bëhet asgjë për të shpëtuar të ardhurat e këtij viti për Republikën. Do të duhet të kalojë një periudhë së paku tetor-nëntor para se të vihen në funksion programet e rishikuara për fabrikat, programet e zhvillimit dhe sistemit arsimor. Siç vihet në dukje më lart, po rikoncepohet i gjithë programi i zhvillimit. Republikat e tjera hezitojnë që të përfshijnë veten dhe kompanitë e tyre në Kosovë. Ato kanë marrë tashmë një afat për paraqitjen e propozimeve konkrete për investimet e tyre të premtuara në Kosovë. Edhe nëse ky afat respektohet, hezitimi i përgjithshëm për të zhvilluar projektet do ta bëjë të pamundur një përpjekje të tillë. Monitorimi i vazhdueshëm do të jetë kusht i domosdoshëm për sukses, por deri më sot nuk ka pasur përpjekje për një gjë të tillë në Kosovë.

Benson



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Skuadra angleze nuk heq dorë nga Ernest Muçi

BESIKTAS, 3 PRILL - Ernest Muçi është duke bërë paraqitje të mira me fanellën e skuadrës së Besiktasit në kampionatin turk. Paraqitja e tij nuk ka shkuar pa u vërejtur nga klubet evropiane. Ndër to është Aston Villa, e cila vijon ta ndjekë dhe

nuk e ka ndër mend të dorëzohet, pasi në fund të këtij sezoni pritet të nisë një tjetër ofensivë për t'i siguruar shërbimet e tij. Villa ka shfaqur interes për Muçin edhe gjatë merkatos së janarit, por në fund dallimin e bënë milionat

e turqve që paguan 10 milionë euro për ta siguruar kartonin e tij nga Legia e Varshavës. Sipas medieve turke, Aston Vila do tentojë edhe një herë në përfundim të këtij sezoni për t'i siguruar shërbimet e Muçit. Sigurisht nuk është e lehtë që

Aston Villa t'i rrëmbejë sulmuesin ekipit turk, pasi Muçi është kthyer menjëherë në një titullar fiks dhe idhull i tifozëve. Në gjashtë ndeshje me fanellën e Besiktasit, Muçi ka realizuar dy gola.



Kupa e Kosovës: Ballkani mposht Suharekën, Prishtina dhe Drita luajnë pa gola

PRISHTINË, 3 PRILL - Prishtina dhe Drita e kanë mbyllur në paqe, ndërsa Ballkani ka mposhtur krejt në fund Suharekën, në kuadër të gjysmëfinalës së parë për Kupën e Kosovës.

Derbi më interesant ishte në mes të Prishtinës e Dritës, ku është zhvilluar lojë e hapur, por epilogu përfundimtar doli të jetë 0:0. Prishtina ishte më agresive në fillim, duke fituar një penallti pas tre minutave lojë, por është anuluar nga VAR-i. "Bardhekaltrit", në fakt, kanë shënuar përmes Leutrim Kryeziut, por sërish VAR-i ia ka

anuluar golin. Këtë herë shkak i një prejke të topit me dorë në aksionin në minutën 22.

Pjesa e dytë ishte edhe më e qetë, pasi të dy skuadrat u treguan më të kujdesshme në mbrojtje, duke mos lejuar befasi. Kësaj, pas 90 minutave lojë asnjëra skuadër nuk ka arritur ta marrë avantazhin dhe finalisti do të mësohet në ndeshjen kthyesë në Gjilan. Edhe derbi i rivalëve lokalë, Suhareka - Ballkani, ishte mjaft interesant, me kampionin e Kosovës që e fitoi lojën krejt në fund. Ballkani, ashtu siç pritej, ishte më i mirë në fushë, por

njësoi si në kohët e fundit po vuan për ta gjetur rrugën drejt rjetës. Rastin më të mirë në pjesën e parë e kishte Nazmi Gripshi, mirëpo goditja e tij përfundoi jashtë portës.

Suhareka më shumë është mbrojtur, duke tentuar disa kundërzbritje, mirëpo larg konkretizimit të tyre. Kur mendohej se sfida do të mbyllej me rezultat 0:0, në skenë ka dalë i inkuadruari Marsel Ismajl Geci që ka realizuar golin e fitores (90+1'). Megjithatë, asgjë s'ka mbaruar as në këtë sfidë dhe finalisti do të mësohet në ndeshjen kthyesë.



Florian Marku pas humbjes: Pritën 14 vjet për ta treguar shpirtin e zi, nuk dorëzohem!



PRISHTINË, 3 PRILL - Me ndeshjen e 31 marsit ndaj Chris Kongo ka përfunduar seria si i pamposhtur në boksion profesionist për Florian Markun. Disa ditë pas ndeshjes, ka reaguar boksieri shqiptar. Marku i ka falënderuar të gjithë ata që humbjen e tij e kanë

përjetuar bashkë me të. "Kanë kaluar disa ditë nga ndeshja. Kam parë edhe lexuar disa komente. Dua të falënderoj nga zemra, sinqerisht, të gjithë ata që e kanë përjetuar këtë humbje me mua edhe sadopak janë munduar me një mesazh pozitiv, të tregojnë përkrahje. Nuk e keni

idenë se sa e vlerësoj secilin prej jush. Ka dhe nga ata që priten 14 vjet që nga hera e fundit që unë kam humbur, të tregojnë shpirtin e tyre të zi, duke u munduar ta njollosin emrin tim", ka shkruar Marku në "Facebook". Marku, përveç që ka potencuar

se nuk do të dorëzohet kurrë, ka thënë se humbja i ka ardhur pasi kundërshtari i tij ishte i papërshtatshëm. "Kurrë nuk jam dorëzuar. Kundërshtari ishte i papërshtatshëm, i doli loja që ai kërkonte duke lëvizur vazhdimisht dhe duke përqafuar tepër", ka shkruar Marku.

Inzaghi i sjell Interit mbi 450 milionë euro të ardhura

MILAN, 3 PRILL - Simone Inzaghi e ka çuar Interin në një nivel të ri dhe puna e tij i ka ndihmuar klubit të sjellë mbi 400 milionë euro të ardhura gjatë tre viteve të fundit. Trajneri 47-vjeçar italian i ka shndërruar Nerazzurët në një nga skuadrat më të forta në Evropë që nga ardhja e tij në vitin 2021, duke i çuar në finalen e Ligës së Kampionëve sezonin e kaluar

dhe duke i vendosur në rrugën e duhur për të fituar Scudetton e 20 historike këtë sezon.

Inzaghi ka më pak se 18 muaj të mbetur në kontratën e tij me Interin, por klubi po planifikon të ulet me trajnerin e tyre në muajt e ardhshëm për të vendosur një marrëveshje të re, për ta blinduar italianin përpara sezonit të ri. Sipas gazetës "Tuttosport", puna e



Inzaghit në skuadrën e Interit gjatë tre viteve të fundit i ka sjellë klubit të paktën 460 milionë euro

falë rezultateve të tyre të forta në garat vendase dhe në Ligën e Kampionëve.

Bilanci ishte tashmë pozitiv në fund të sezonit 2022/23 me fitime prej 270 milionë eurosh, ndërsa këtë vit do t'i shtojnë edhe 190 milionë euro të tjera.

Në fund të këtij sezoni, Nerazzurët do të mbledhin rreth 190 milionë euro të ardhura, kualifikimin në

Ligën e Kampionëve (50 milionë euro), sezonin e tyre 2023/24 në Ligën e Kampionëve (rreth 85 milionë euro) dhe kualifikimin e Kupës së Botës për Klube (50 milionë euro). Këtyre shifrave i shtohen edhe fitimet e tyre si rezultat i fitores së tyre në Scudetto, Superkupën e Italisë dhe të gjitha marrëveshjet e tyre të ndryshme nga sponsorizimi.

"Imagjino gardën e nderit nga Real Madridi", Vedat Muriqi ëndërron Kupën e Spanjës

MALLORCA, 3 PRILL - Skuadra e Mallorcas është duke u përgatitur për finalen e madhe të Kupës së Spanjës që e zhvillon gjatë këtij vikendi ndaj Athletic Bilbaos. Sulmuesi i Kombëtares së

Kosovës, Vedat Muriqi, në një intervistë ka thënë se mezi po e pret këtë finale. Madje futbollisti nga Kosova ëndërron të triumfojë në këtë kompeticion dhe më pas t'i bëhet garda e nderit nga Real

Madridi. "Imagjino një skuadër si Real Madridi duke iu bërë juve një gardë të nderit nëse fitojmë në 'Copa del Rey'. Një nderim për Muriqin, që pas disa viteve ishte kamerier. Kjo do të ishte e bukur të

them të drejtën", ka thënë Muriqi.

Ndeshja mes Athletic Bilbaos dhe Mallorcas zhvillohet të shtunën nga ora 22:00 në stadiumin "La Cartuja" në Sevilla.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "A Desing Consulting" shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore 9.98 MW në lokalitetin "Shkom", ZK. Gjonaj, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.05.2024 në ora 11:00 në Sallën e Qendrës Kulturore Boshnjake KK Prizren, Adresa: Ahmet Prishtina p.n. Prizren, do të organizohet debat publik nga Kompania "A Desing Consulting" shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 9.98 MWp në Gjonaj, Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/8497757928?pwd=Y13l1gNS7yT1zAgsRnDbzrdshEDrly.1>

Meeting ID: 849 775 7928
Passcode: Y4J7Hj

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "A Desing Consulting" shpk, Prishtinë, për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 9.98 MWp në Gjonaj, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "EBK" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore 9.98 MW në lokalitetin "Shkom", ZK. Gjonaj, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.05.2024 në ora 11:30 në Sallën e Qendrës Kulturore Boshnjake KK Prizren, Adresa: Ahmet Prishtina p.n. Prizren, do të organizohet debat publik nga Kompania "EBK" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 9.98 MWp në Gjonaj, Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/8976973856?pwd=6JkwqJta09hM9GL6HFN1Et54b63dlk.1>

Meeting ID: 897 697 3856
Passcode: hyYGr9


Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "EBK" Sh.p.k Prizren, për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 9.98 MWp në Gjonaj, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Komuna e Gjakovës
Opština Gjakovë Municipality
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË
Nr: 1/1
Data: 03.04.2024



N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË

KE: 0390/320 010
E-mail: nplsagj@gmail.com
Info: 0390/324 268
Web:

NU: 811444900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 140200001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Regullimin e Porcedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve dhe neni 15 pika 16 të Rregullores nr.121 të dt. 04.04.2016 për Organizimin e Mbrendshëm, Caktimin e Pozitave, Detyrave dhe Përgjegjësisë të Stafit Punues, dhe vendimit nr. 170 të datës 03.04.2024 të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Stacioni i Autobusëve"SH.A., Gjakovë, shpallë këtë:

KONKURS

Pozita: Laurist / Porter

Numri i pozitave: 2 (dy)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Regjistron hyrje-daljet e autobusëve dhe mban evidence për emrin e firmës, relacionin dhe kohën e nisjes;
- Verifikon operatorët me rastin e lëshuarjes së objektit se, a i kanë në rregull fletëleshimet-biletën e paguar të peronizimit për relacionin në fjalë dhe në librin e posaqem të evidencës regjistrojnë kohën e daljes;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Stacionit.

Paga për këtë pozitë: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordit i Drejtorëve.

Kushtet për pjesmarrje: Kualifikimi dhe Aftësitë:

- Përgaditje mesme shkollore;
- 1 (një) vit përvojë pune e domosdoshme;
- Të jetë i aftë për punë me presion dhe të ketë shkathtësi në kordinimin e punëve rutinore;
- Të jetë komunikues dhe të njoh ndonjë gjuhë të huaj;
- Njohja e punës me programe kompjuterike përparësi;
- Të mos jetë nën hetime për vepër penale;

Dokumentacioni i kërkuar:

- Diploma mbi shkollimin.
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Kopja e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj;
- Aplikacioni për punësim i plotësuar dhe i nënshkruar

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjestarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2.

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2 tek Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Konkursi është i hapur nga data: 04.04.2024 deri më 18.04.2024.


-Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.

Paraqitja e kërkesave: Kërkesat - Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kandidatët me dokumentacion të pa - kompletuar, të pa-plotësuar dhe joadekuat do të refuzohen.

-Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

-Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Gjakovë, më 03.04.2024





Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë me datë 03.04.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : 1 Pozita VOZITËS-/ I AUTOMJETEVE PËR BARTJEN E HEDHURINAVE
(vendi i punë Klinë)

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

- 1.Drejton automjetin, kujdeset për rregullsin e tij dhe është përgjegjës për vozitjen e sigurt, duke i respektuar rregullat e komunikacionit.
- 2.Kujdeset për higjienën dhe pastërtin e automjetit, pas kryerjes së punës bënë larjen e automjetit.
- 3.Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga Kryepunëtori në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve
- 4.Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për fikjen zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion.
- 5.Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të bënë ndreqje të vogla, si nderimin e gomës, pastrimin e filterit etj. të qëndrori pran automjetit në puntori dhe ti ndihmoimekanikut ose gomistit.
- 6.Çdo mëngjez është i obliguar të kontrolloi sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në makinë.
- 7.Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtëpërdrejt.
- 8.Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit apo Menaxherit të Operatives.
- 9.Është i obliguar te menaxhoi dhe të mbaj nen kontrole ekipin e punetoreve fizik.
10. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives
11. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kyeshefit Ekzekutiv

Kushtet:

- Shkollimin e mesem
- Përgaditje profesionale-voztësi kategorive përkatëse
- 2 (dy) vite përvojë pune.
- Aftesi fizike dhe psikike te deshmuar
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 19.04.2023. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A PEJË
NR. 309
DATA 03.04.24

NJOFTIM

Njoftojme te githe klientet se Shogeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ERWA Grinding Machine Service" L.L.C me seli në Prizren, ka marre vendim te shuajë biznesin me nrb UNIK: 810177403, dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te githe klientët qe kane raporte Kreditore - Debitore ne këte korporate që te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ERWA Grinding Machine Service" D.O.O. od Prizrena, donelo odlukuo prestani rada sa nrb. 810177403, ujedno imenovao Likvidatorao sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavijivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "ERWA Grinding Machine Service" L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 810177403, the company has appointet a liguidator who is going to oversee the liguidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to showup within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojme te githe klientet se Shogeria me Pergjegjesi te Kufizuar "TIM TRAVELS PLUS" D.O.O me seli ne Severna Mitrovica, ka marre vendim te shuajë biznesin me nrb UNIK: 811847956, dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te githe klientët qe kane raporte Kreditore - Debitore ne këte korporate që te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "TIM TRAVELS PLUS" D.O.O. od Severna Mitrovica, donelo odlukuo prestani rada sa nrb. 811847956, ujedno imenovao Likvidatorao sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavijivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "TIM TRAVELS PLUS" L.L.C. with headquarters Severna Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811847956, the company has appointet a liguidator who is going to oversee the liguidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to showup within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Atdhe Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Leonard Nrecaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gresa Grajqevci shpall të pavlefshme ID-Kartelën e Kolegjit AAB Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1403 të datës 03.04.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 04.04.2024 shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Zyrtar për Arka Fiskale

Numri i poziteve: 1

Niveli i Pagës: XIII

Kohëzgjatja e kontratës: Ne afat të pacaktuar

Kualifikimet: Diplomë Universitare

Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune

Periudha provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Fakulteti Ekonomik
- 1 vit përvojë pune
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune> ;
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **04.04.2024** dhe përfundon më datë **18.04.2024** në ora **24.00**.

Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **13.05.2024**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
03.04.2024

NPK "Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



U skladu sa članom 8. Zakona br. 03/L-212 člana 5, 7 i 8 Administrativnog uputstva br.01/2024 o pravilima i procedurama konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), tačka 10 tačka 1,5 i 11 tačka 1 od Uredba br.1074 od 21.08.2017godine o nalazu na radu i Rešenje br.1403 od 03.04.2024 godine, NPK "Trafiku Urban"SHA – Priština, od 04.04.2024

JAVNI KONKURS

Radno mesto: Fiskalni blagajnik

Broj pozicija: 1

Nivo plate: XIII

Trajanje ugovora: Neograničeno

Kvalifikacije: Univerzitetska diploma

Radno iskustvo: 1 godina radnog iskustva

Probni period: 3 meseca

Dužnosti i odgovornosti:

O obavezama i odgovornostima posla možete se informisati putem web-a: www.trafikurban-pr.com, u odeljku O nama, Izveštaji/Redovno.

Kvalifikacije i veštine:

- Ekonomski fakultet
- 1 godina radnog iskustva
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- Nijedan disciplinski postupak nije u toku.

Potrebna dokumentacija:

Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;

- CV
- Dokaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- Dokaz o dokazanom radnom iskustvu u Trustu;
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;

• Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost. Svako materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna izmena informacija datih u gornjoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike. Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Način primene:

Prijava se može izvršiti samo putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com
Konkurs je otvoren od **04.04.2024** i završava se **18.04.2024** u ponoć.
Okvirni kalendar izrade procedura: Nakon okončanja procedura otvaranja konkursa, planirano je da se procedure izrade završe najkasnije do **13.05.2024**.

Način vrednovanja kandidata/prijavljenih

- Pismeni test – maksimalno 70 poena
- Intervju – maksimalno 20 poena
- CV – maksimalno 10 bodova

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.

Datum:
03.04.2024

NPK "Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1398 të datës 03.04.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 04.04.2024 shpall:

KONKURSI JASHTËM

Posita e punës: Zyrtar për Kamera, GPS dhe Panele Informuese të Autobusëve

Numri i pozitave: 1

Niveli i pagës: XII

Kohëzgjatja e kontratës: Ne afat të pacaktuar

Kualifikimet: Diplomë Universitare

Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune

Periudha provuese: 3 muaj

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Ne lidhje me pozitën e punës i gjeni në web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën - Rreth nesh, Raporte/Rregullore

Përgatitja profesionale:

- Diplomë universitare - Menaxhment, Informatikë; Shkenca Kompjuterike; Shkenca Teknike - drejtimi Kompjuterikë; Shkenca Teknike Telekomunikacion
- 1 vit përvojë pune
- Aftësi shumë të mira të punës me kompjuter;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit: punesimi@trafikurban-pr.com

Konkursi është i hapur nga data 04.04.2024 dhe përfundon më datë 18.04.2024 në ora 24.00.

